

الله  
رسول  
محمد

# MARRJA E KUR'ANIT SI UDHËRRËFYES

(Thuaj) “A pos All-llahut të kërkoj unë gjykatës (mes meje dhe juve)? Kur Ai është që ua zbriti Librin që qartëson çdo gjë?” Atyre që u dhamë Librin e dinë se ai (Kur’ani) është i zbritur prej Zotit tënd saktësisht, pra assesi mos u bë prej atyre që dyshojnë.

(Sure En’am: 114)

**HARUN JAHJA  
(ADNAN OKTAR)**

**K**ur njerëzit i pyesin për fenë e tyre, shumica e njerëzve thonë se ata janë myslimanë. Megjithatë, shumë prej tyre nuk e kanë lexuar Kur'anin, vetë Librin e Islamit, goftë dhe një herë të vetme. Kur'ani është shpallje e All-llahut nëpërmjet të cilit paraqet veten dhe shpjegon qëllimin e vërtetë të jetës sonë, të kësaj bote dhe në tjetrën, si dhe atributet e përsosmërisë morale. Duke bërë një jetë të pandërgjegjësuar në besimin tek Allahu dhe të qenurit i kënaqur me fetë e sajuara nuk është e përshtatshme për ndërgjegjen dhe urtësinë e personit.

Qëllimi i këtij libri është të shpjegojë se Kur'ani është Fjala e All-llahut, një udhëzim për njerëzimin që i drejtohet të gjithëve, dhe urdhëresat në të janë të zbatueshme për të gjitha kohrat. Kështu që Ai duhet të jetë referimi më i rëndësishëm. Një kuptim i saktë i Islamit dhe kuptim i drejtë i vargjeve të tij janë thelbësore për ata që kërkojnë të udhëzohen prej tij. Në këtë drejtim, një nga detyrat më të rëndësishme për çdo Musliman i cili ka dituri, ndërgjegje dhe sens të përbashkët është që të përcjellë mesazhin e tij tek njerëzit.



## DY FJALË RRETH AUTORIT

I njohur me emrin HARUN JAHJA, Adnan Oktar, u lind në Ankara në vitin 1956. Pasi kreu studimet fillore dhe të mesme në Ankara, ai studioi për arte në Universitetin Mimar Sinan në Stamboll dhe filozofi në universitetin e Stambollit. Që nga viti 1980, ai ka botuar mjaft libra në lidhje me çështje politike, shkencore, dhe fetare. Duke qenë mjaft të vlerësuara në të gjithë botën, këto vepra kanë shërbyer për shumë njerëz si mjet për të gjetur besimin në Zot dhe për të arritur një njohje më të thellë për besimin e tyre. Librat e Harun Jahjasë u drejtohen të gjithë lexuesve, pa marrë parasysh moshën, racën, apo kombësinë e tyre, sepse ata përqendrohen në një synim: të hapin horizontin e lexuesit duke e nxitur atë të mendojë për disa çështje të rëndësishme, si qenia e Allahut dhe Njëshmëria e Tij dhe të jetuarit sipas vlerave që Ai ka përcaktuar për ne.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

اللَّهُ  
رَسُولُ  
مُحَمَّدٍ



# MARRJA E KUR'ANIT SI UDHËRRËFYES

HARUN JAHJA  
(ADNAN OKTAR)



## Dy fjalë rreth autorit dhe veprave të tij

I njohur me emrin HARUN JAHJA, Adnan Oktar, u lind në Ankara në vitin 1956. Pasi kreu studimet fillore dhe të mesme në Ankara, ai studioi për arte në Universitetin Mimar Sinan në Stamboll dhe filozofi në universitetin e Stambollit. Që nga viti 1980, ai ka botuar mjaft libra në lidhje me çështje politike, shkencore, dhe fetare. Harun Jahja është njohur mirë si autor i veprave të rëndësishme, të cilat zbulojnë mashtrimin e evolucionistëve, pohimet e tyre të pavërteta dhe lidhjet e errëta midis Darwinizmit dhe ideologjive gjakësore, të tilla si: fashizmi dhe komunizmi.

Veprat e Harun Jahjasë, të përkthyer në 72 gjuhë të ndryshme, përbëjnë një koleksion prej mëse 55,000 faqesh me 40,000 ilustrime. Pseudonimi i tij është një ndërthurje e emrave të Harunit (Aaron) dhe Jahja (John), në kujtim të dy Profetëve të nderuar, të cilët luftuan kundër mohimit të besimit. Vula e Profetit në librat e tij është një simbol i cili është i lidhur me përmbajtjen e tyre. Ky simbol paraqet Kur'anin (Shpalljen e Fundit) dhe Profetin Muhamed (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të), Profetin e fundit. Nën dritën e udhëzimit të Kur'anit dhe Sunnetit (traditës dhe mësimëve të Profetit), autori i ve vetes si qëllim të hedhë poshtë çdo ngrehinë të ideologjive që mohojnë fenë dhe të thotë "fjalën e fundit" në mënyrë që ta bëjë të heshtë çdo kundërshtim ngritur kundër fesë. Ai e përdor vulën e Profetit të fundit (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të), i cili arriti urtësinë më të lartë dhe përsosmërinë morale, si një shenjë të qëllimit të tij për të ofruar fjalën e fundit.

Të gjitha veprat e Harun Jahja kanë një qëllim të përbashkët: të japin mesazhin e Kur'anit, të inkurajojnë lexuesit për të menduar mbi çështje që kanë të bëjnë me besimin, si për shembull, ekzistenca e Allahut dhe njëshmëria e Tij dhe besimi në Botën Tjetër dhe njëkohësisht të nxjerrë në pah rrejtë e kalbura të sistemeve antifetare dhe ideologjive të devijuara.

Harun Jahja gëzon një rang të gjerë lexuesish në shumë vende të botës, që nga India në Amerikë, nga Anglia në Indonezi, Poloni, e deri në Bosnjë, Spanjë, Brazil, Malajzi, Itali, Francë, Bullgari, e deri në Rusi. Disa nga librat e tij mund të gjenden në gjuhën Angleze, Frënge, Gjermane, Spanjolle, Italiane, Portugeze, Urdu, Arabe, Shqipe, Kineze, Dhivehi (folur në ishujt Mauritius) Ruse, Serbo-Croate (Boshnjake), Polake, Malaje, Turke, Uygur, Indoneziane, Bengali, Daneze dhe Suedeze.



Duke qënë mjaft të vlerësuara në të gjithë botën, këto vepra kanë shërbyer për shumë njerëz si mjet për të gjetur besimin në Zot dhe për të arritur një depërtim më të thellë në besimin e tyre. Mençuria dhe sinqeriteti që i karakterizojnë librat e tij, së bashku me një stil të veçantë që është i lehtë për t'u kuptuar, ndikon drejtpërdrejt çdokënd që i lexon. Ata që i studiojnë me kujdes këta libra, nuk mund të mbrojnë më ateizmin apo ndonjë ideologji tjetër të devijuar apo filozofi materialiste, sepse këta libra karakterizohen nga një ndikim i shpejtë, përfundime të qarta dhe janë të pakundërshtueshëm. Edhe nëse këta njerëz do të vazhdojnë të këmbëngulin në të tyren, nuk do të jetë gjë tjetër veçse një këmbëngulje të kotë, sepse këta libra përmbysin ideologji të tilla që nga themelet. Të gjitha lëvizjet bashkëkohore antifetare tashmë mbrohen ideologjikisht, falë librave të shkruar nga Harun Jahja.

Kjo është, pa dyshim, një rezultat i urtësisë dhe dritës së Kur'anit. Autori në mënyrë modeste dëshiron të shërbejë si një mjet në kërkimin njerëzor të rrugës së drejtë të Allahut. Prej botimit të këtyre materialeve nuk kërkohet asnjë përfitim material.

Ata njerëz që inkurajojnë të tjerët për të lexuar këto libra, për të hapur mendjet dhe zemrat e tyre dhe për t'i udhëzuar ata të bëhen robër të devotshëm të Allahut, kryejnë një shërbim të paçmuar.

Njëkohësisht, do të ishte një humbje kohe dhe energjie për të reklamua libra të tjerë, të cilët krijojnë çoroditje në mendjet e njerëzve, i shpjen ata në kaos ideologjik dhe që nuk kanë një ndikim të fortë dhe preciz në largimin e dyshimit prej mendjeve të njerëzve, siç është vërtetuar nga përvoja e përparshme. Për librat që janë shkruar vetëm e vetëm për të nxjerrë në pah fuqinë letrare të shkrimtarit se sa qëllimin fisnik për t'i shpëtuar njerëzit nga mungesa e besimit është e pamundur që të kenë një ndikim kaq të madh. Ata që e venë në dyshim këtë mund të shohin qartë se qëllimi i vetëm i librave të Harun Jahjasë është të mposhtë mosbesimin dhe, njëkohësisht, të përhapë vlerat morale të Kur'anit. Suksesi dhe ndikimi i këtij shërbimi shfaqen qartë në bindjen e lexuesve.

Një gjë duhet të mbahet parasysh: Arsyja kryesore për vazhdimin e mizorisë, konflikteve dhe telasheve të tjera që po përjetojnë shumica e njerëzve sot është mbizotërimi ideologjik i mosbesimit. Kësaj mund t'i jepet fund vetëm me mposhtjen ideologjike të tij dhe, njëkohësisht, duke transmetuar mrekullitë e krijimit dhe moralin e Kur'anit, në mënyrë që njerëzit të jetojnë sipas tij. Duke patur parasysh gjendjen e botës sot, që po precipiton në një spirale dhune, korrupsioni dhe lufte, është e qartë se ky shërbim duhet të jepet shpejt dhe në mënyrë të suksesshme, përndryshe, do të jetë tepër vonë.

Në këtë drejtim, librat e Harun Jahjasë marrin një rol udhëheqës. Me lejen e Allahut, këto libra do të jenë një mjet, nëpërmjet të cilit njerëzit në shekullin e XXI do të gjejnë paqen, drejtësinë, dhe lumturinë e premtuar në Kur'an.

## PËR LEXUESIN

Të gjithë librat e Harun Jahjasë shpjegojnë tema që kanë lidhje me besimin nën dritën e vargjeve kuranore dhe i ftojnë lexuesit të mësojnë fjalët e Allahut dhe të jetojnë në përputhje me to. Të gjitha çështjet në lidhje me ajetet kuranore janë shpjeguar në mënyrë që të mos lihet vend për dyshim apo për pyetje në mendjen e lexuesit. Stili i thjeshtë dhe i rrjedhshëm i librave bën të mundur që çdo njeri i çfarëdo moshe qoftë dhe i çfarëdo grupi shoqëror t'i kuptojë ata me lehtësi. Falë shpalosjes së tyre mbresëlënëse dhe të ndritshme, ata mund të lexohen me një frymë. Madje, edhe ata njerëz që e refuzojnë besimin ndikohen nga faktet që dokumentojnë këta libra dhe nuk mund të hedhin poshtë vërtetësinë e përmbajtjes së tyre.

Ky libër, po ashtu, të gjithë librat e Harun Jahja mund të lexohen vetëm ose të diskutohen në grup. Lexuesit e etur për të përfiturar nga librat do të zbulojnë se diskutimi është mjaft i dobishëm dhe u mundëson atyre të shkëmbejnë mendimet dhe përvojën e tyre me të tjerët.

Një shërbim i madh për Islamin do të ishte ndihma në botimin dhe leximin e këtyre librave shkruar vetëm për hir të Allahut. Të gjithë librat e Harun Jahjasë janë jashtëzakonisht bindës. Për këtë arsye, për t'ia komunikuar të tjerëve fenë e vërtetë, një nga mënyrat më të dobishme do të ishte nxitja për të lexuar këta libra.

Shpresojmë se, lexuesi do t'i hedhë një sy përmbledhjeve të librave të tjerë të autorit, të cilat janë vendosur në pjesën e pasme të këtij libri. Lënda e tij e pasur në çështjet e besimit është mjaft e dobishme dhe të sjell kënaqësi në lexim.

Në këta libra, ndryshe nga librat e tjerë, janë mënjeluar tërësisht pikëpamjet personale të autorit, shpjegimet e bazuara në burime të dyshimta, stile që nuk i kushtojnë kujdesin e duhur temave fetare, dhe as argumente të pashpresë apo pesimistë, të cilët krijojnë dyshime në mendjen e lexuesit dhe mosbesim në zemrat e tyre.



# MARRJA E KUR'ANIT SI UDHËRRËFYES

(Thuaj) "A pos All-llahut të kërkoj unë gjykatës (mes meje dhe juve)? Kur Ai është që ua zbriti Librin që qartëson çdo gjë?" Atyre që u dhamë Librin e dinë se ai (Kur'ani) është i zbritur prej Zotit tënd saktësisht, pra asesi mos u bë prej atyre që dyshojnë.

(Sure En'am: 114)

## **GLOBAL PUBLISHING**

Kayisdagi Mah. Degirmen Sok. No: 3  
Ataşehir-Istanbul / TURKEY Phone: (+90 216)  
660 00 59

Printed by: Secil Ofset  
100. Yil Mahallesi MAS-SIT Matbaacilar Sitesi  
4. Cadde No: 77 Bagcilar -Istanbul / Turkey  
Phone: (+90 212) 629 06 15

E-Mail: [info@globalkitap.com](mailto:info@globalkitap.com)  
**<http://globalkitap.com>**

---

**[www.harunyahya.com/albanian](http://www.harunyahya.com/albanian)**  
**[www.harunyahya.com](http://www.harunyahya.com)**  
**[www.en.harunyahya.TV](http://www.en.harunyahya.TV)**

# PËRMBAJTJA

---

PARATHËNIE-10

ALLAHU PREMTOI TË MBROJË KUR'ANIN-13

ALLAHU ËSHTË I VETMI GJYKUES-18

ATA TË CILËT GJYKOJNË NË EMËR TË ALLAHUT-24

MARRJA E KUR'ANIT SI UDHËRRËFYES-30

KUR'ANI ËSHTË PËRKUJTUES PËR TË GJITHA BOTËRAT-33

KUR'ANI ËSHTË KRITERI QË BËN DALLIMIN MIDIS  
TË DREJTËS DHE TË GABUARËS-37

ALLAHU SQARON GJITHÇKA NË KUR'AN-41

TË JETUARIT SIPAS VLERAVE TË KUR'ANIT  
ËSHTË I LEHTË-45

BINDJA NDAJ KUR'ANIT IA LARGON BARRËN  
E NJERËZIMIT-49

ALLAHU PARALAJMËRON NJERËZIMIN ME  
ANË TË KUR'ANIT-54

MUSLIMANËT JETOJNË PLOTËSISHT SIPAS VLERAVE  
TË KUR'ANIT-59

UDHËRRËFYESI I VETËM I PROFETIT TONË (SAAS)  
ISHTE KUR'ANI-61

EDUKIMI I NJË BREZI MODEL QË PASON KUR'ANIN-65

PËRFUNDIM-69

MASHTRIMI I EVOLUCIONIT-72

# PARATHËNIE

**S**hoqëritë që janë të larguara prej fesë e kuptojnë atë në mënyrë të shtrembëruar, dhe popujt e tyre, ndërsa formohen, mbledhin informacionin e tyre për të prej burimeve krejtësisht të dyshimta. Për këtë arsye, nën maskën e fesë njerëzit përvetësojnë rituale, rregulla, të drejta dhe padrejtësi të ndryshme që ata mendojnë se u përshtaten atyre. Mirëpo, burimi kryesor i diturisë së saktë për fenë e vërtetë është Kur’ani, sepse ai është Fjala sublime e Allahut, Zotit tonë i Cili krijoi gjithësinë nga asgjëja dhe Ai i Cili ka dijeni për gjithçka.

Stili i qartë i Kur’anit e bën atë të kuptueshëm për të gjithë njerëzit në mënyrë që ata të përfitojnë nga urtësia e tij unike. Mirëpo, përkundër kësaj, ata të cilët nuk janë të sinqertë apo që janë madje armiqësor ndaj Allahut dhe fesë së Tij i qasen Kur’anit me paragjykim dhe të ndikuar nga arsyeja e tyre e shtrembëruar, i keqinterpretojnë vargjet e tij. Disa njerëz, duke shpresuar që ta paraqesin fenë si një gjë të vështirë, fabrikojnë shumë besime të rrejshme, herezi dhe mite.

Besimtarët, të cilët e njohin mirë Kur'anin, e kuptojnë se trillime të tilla nuk janë asgjë më shumë se mite dhe kështu nuk i pranojnë ato. Mirëpo, ata të cilët nuk e njohin Allahun dhe Kur'anin mbeten në ndikimin e këtyre miteve nga mosdija dhe kështu pandehin se kjo fe e rrejshme, e cila nuk bazohet në Kur'an, është feja e vërtetë. Veç kësaj, ata dështojnë të shohin bukuritë e paraqitura nga Islami, të cilat Allahu i ka zgjedhur dhe përsosur, për arsye se ata nuk e lexojnë Kur'anin.

Është interesant fakti se Kur'ani, të cilin Allahu e dërgoi për të udhëzuar njerëzimin në rrugën e drejtë, kurrë nuk tërheq vëmendjen e njerëzve të tillë. Kur ata pyetën diçka në lidhje me fenë, ata shikojnë gjithkund përveç në Kur'an, edhe pse ai është burimi i vetëm i saktë i zbatueshëm për të gjitha kohërat. Kur'ani e shpreh këtë si: **“E i Dërguari tha: ‘O Zoti im, vërtet, populli im e konsideroi këtë Kur'an si (diç) që duhet injoruar’”** (Sure Furkan: 30).

Në të vërtetë, Kur'ani është burimi i vetëm i besueshëm i Islamit, sepse ai është fjala e pandryshuar e Allahut dhe Sunneti (që Profeti Muhammed (saas) vendosi me anë të thënieve, veprave dhe miratimit të heshtur). Allahu shpalli Kur'anin në mënyrë që njerëzimi ta lexonte dhe ta kuptonte atë; të fitonte dituri të saktë për Zotin e Tij, I Cili krijoi gjithësinë nga asgjëja; të mësojë se si ta adhurojë Atë dhe se si të veprojë në përputhje me urdhërat e Tij për të fituar kënaqësinë e Tij. Allahu shpjegoi/sqaroi vargjet e Tij përmes shembujve dhe tregimeve. Siç e bën të qartë në: **“Asgjë nuk kemi lënë pas dore në Libër”** (Sure En'am: 38), Kur'ani përfshin çdo gjë. Hollësira të shumta që i përkasin kësaj bote dhe botës tjetër shpjegohen në mënyrën më të kuptueshme, sepse, siç na njofton Allahu: **“Ne ty ta**

**shpallëm Librin që sqaron çdo gjë dhe si udhëzim e mëshirë dhe myzhde për Muslimanët.”** (Sure Nahl: 89).

Qëllimi i këtij libri është të shpjegoj se Kur’ani është Fjala e Allahut, udhëzim për njerëzimin që i drejtohet çdonjërit dhe se urdhërat e tij janë të zbatueshme për të gjitha kohërat. Prandaj ai duhet të jetë referimi më i rëndësishëm.

Një kuptim i saktë i Islamit dhe kuptim i drejtë i vargjeve të tij janë thelbësore për ata të cilët duan të udhëzohen prej tij. Në këtë kuptim, njëra prej detyrave më të rëndësishme për çdo Musliman i cili posedon mençuri, ndërgjegje dhe mendje të shëndoshë është t’ua përcjellë porosinë e tij gjithë njerëzve.

# ALLAHU KA PREMTUAR SE DO TA MBROJË KUR'ANIN

*Ne me madhërinë Tonë e shpallëm Kur'anin  
dhe Ne gjithsesi jemi mbrojtës të tij.  
(Sure Hixhr: 9)*

**N**jëra prej vetive më të rëndësishme të Kur'anit është se ka arritur tek ne në po atë formë në të cilën iu shpall Profetit tonë (saas). Në: **“Ne e zbritëm Përkujtuesin, dhe Ne do ta mbrojmë atë”** (Sure Hixhr: 9), Allahu premtoi se do ta mbrojë atë.

Shkrimet Hyjnore që u shpallën para Islamit humbën format e tyre origjinale me kalimin e kohës; ata janë ose të mangëta ose nuk janë plotësisht të sakta. Mirëpo, në rastin e Kur'anit, Allahu vendosi shpalljet në kujtesën e Profetit tonë (saas). Veç kësaj, pasi që ai pranoi secilën shpallje, Profeti (saas) u tha Shoqëruesve të tij të shumtë t'i shkruajnë ato, duke siguruar në këtë mënyrë ruajtjen e tij në formën e tij origjinale tekstuale. Kalifi Ebu Bekër (632-634) e kishte grumbulluar Kur'anin në një kopje të vetme, dhe Kalifi Uthman (644-656) dërgoi kopjet e tij në qytetet e rëndësishme Islamike. Vargjet në

vijim shpjegojnë mënyrën se si Profeti jonë (saas) u përpoq të mbaj në mend shpalljet dhe mënyrën se si Allahu i ndihmoi atij ta bëjë këtë:

**Ti (Muhammed) mos shqipto atë (Kur'anin) me gjuhën tënde për ta nxënë atë me të shpejtë! Sepse Ne e kemi për detyrë tubimin dhe leximin e tij. E kur ta lexojnë atë ty, ti përcille me të dëgjuar leximin e tij. Dhe pastaj është obligim i Yni që ta shpjegojmë atë. (Sure Kijame: 16-19)**

Siç pohohet në këto vargje, Profeti jonë (saas) e mbajti në mend Kur'anin në mënyrë unike, sepse Allahu i rrënjosi vargjet e tij në mendjen e tij. Meqenëse Shoqëruesit e tij i shkruajtën të gjitha gjersa ai ishte ende gjallë, në pajtim me premtimin e Tij, secila prej shkronjave të tij ka mbetur e pandryshuar që nga fillimi i shpalljes së tij mbi 1,400 vjet më parë. Prandaj, shpallja e Allahut ka mbijetuar e paprekur deri në ditët tona.

Mungesa në Kur'an e çfarëdo kundërthënie dhe mospajtimi të brendshëm poashtu tregon se është prej Allahut dhe është imun ndaj ndryshimeve. Kur'ani është nga brenda i qëndrueshëm dhe në harmoni të plotë me zhvillimet historike dhe zbulimet shkencore. Kjo veti është aq e sigurt dhe e qartë sa që Zoti ynë pohoi:

**A nuk e përfillin ata (me vëmendje) Kur'anin? Sikur të ishte prej dikujt tjetër, përveç prej All-llahut, do të gjenin në të shumë kundërthënie. (Sure Nisa: 82)**

Shumë kundërthënie mund të gjehen në librat e zakonshëm. Mirëpo, çdo fjalë e Kur'anit është në harmoni të plotë me të tjerat. Veç kësaj, Kur'ani ofron informacion për gjeneratat e mëparshme, komunitetet, format e ndryshme të administrimit, strategjitë ushtarake dhe për shumë çështje tjera, si edhe për ngjarjet e të



kaluarës dhe të ardhmës. Kur’ani është gjithashtu në harmoni absolute me faktet historike si edhe me të gjitha zhvillimet që ndodhën pas shpalljes së tij. Për shembull, vargjet e para të Sures Rum (Perandoria Bizantine) shpallin se Perandoria Bizantine do të pësonte një disfatë të rëndë, por megjithatë do të ishte fitimtare pak kohë pas kësaj, si vijon:

**Elif, Lamë, Mimë. Bizantinët (Romakët) u mundën, në tokën më të ulët, por pas disfatës së tyre, ata do të ngadhënjëjnë, brenda pak viteve. Çështja është vendim i All-llahut, fillim e mbarim (për disfatë dhe për fitore). (Sure Rum: 1-4)**

Këto vargje u shpallën rreth vitit 620, gadi 7 vjet pasi që Persianët idhujtarë mposhtën Bizantinët e Krishterë. Në të vërtetë, Bizanti ishte mposhtur aq rëndë sa që vet mbijetesa e tij ishte në pikëpyetje. Pra fitorja e parashikuar e tij dukej e pamundshme për shumë njerëz, duke përfshirë Arabët politeist.

Në Dhjetor të vitit 627, perandoritë Bizantine dhe Persiane zhvilluan një betejë vendimtare në Nineveh. Këtë herë, Bizantinët papritur mposhtën Persianët. Disa muaj më vonë, Persianët u detyruan ta bëjnë një marrëveshje me Bizantin, e cila i obligonte ata t’i kthejnë territoret e Bizantit. Në fund, “fitorja e Romakëve” që Allahu e premtoi në mënyrë të mrekullueshme u realizua. Ky shembull i vetëm ofron dëshmi se Kur’ani është Fjala e Allahut.

Një veti tjetër e Kur’anit është se ai përmban fakte kyçe në lidhje me shumë çështje (për shembull, për astronomi, fizikë dhe biologji), në një kohë kur njerëzit kishin shumë pak dijeni për gjëra të tilla. Kur’ani iu shpall banorëve të shekullit të shtatë të Arabisë, shoqëria e të cilëve përmbante shumë besime paragjykuese dhe të pabaza që

merreshin si “shkencore.” Duke mos pasur teknologjinë për ta studiuar gjithësinë dhe natyrën, ata besonin në legjenda të trashëguara prej gjeneratave të kaluara. Për shembull, ata mendonin se mallet mbështetnin qiellin, se Toka ishte e rrafshët dhe kishte male të larta në të dy skajet e saj dhe se këto male shërbenin si shtylla për të mbajtur kupën qiellore lart mbi kokat e tyre. Kur’ani mënjanoi paragjykimet/bestytnitë e tilla, siç lexojmë në:

**All-llahu është Ai që ngriti qiejt pa ndonjë shtyllë. Ju i shihni ato... (Sure Rra’d: 2)**

Disa të vërteta shkencore vetëm tani së voni të zbuluara me anë të teknologjisë u shpallën në Kur’an 1,400 vjet më parë. Faktet e tilla janë dëshmi tjera se Kur’ani është Fjala e Allahut (Për informacion më të hollësishëm, shiko *Mrekullitë e Kur’anit* të Harun Jahjasë, Botimet e Al-Attique të vitit 2000)

Kur’ani është i shkruar në një gjuhë me një bukuri dhe pasuri të pakrahasueshme sa që ia kalon të folurit e rëndomtë. Në kohën e shpalljes së tij, poetët Arab garonin me njëri tjetrin për të krijuar veprat më të mira letrare. Mirëpo, stili në mënyrë unike i bukur i Kur’anit fitoi admirimin e tyre dhe nuk mund e të mos pranoni natyrën e tij të mrekullueshme në kuptimin letrar.

Nëse e lëmë këtë anash, një kod matematikor i ndërlikuar, fare i pakapshëm për inteligjencën njerëzore, është i rrënjësor në ndërtimin e Kur’anit. Disa fjalë të lidhura përsëriten në numër të njëjtë në Kur’an. Për shembull: fjala ditë përsëritet 365 herë, *ditët* përsëritet 30 herë, *muaji* përsëritet 12 herë, *shejtan dhe engjull* përsëritet 88 herë, *bota/dynjaja* dhe *jeta e përtejme/ahireti* përsëriten 115 herë, *veranxehtësia* dhe *dimri-të ftohtit* përsëriten 5 herë, *ndëshkimi* përsëritet

117 herë, *falja* përsëritet 234 herë (dyfishi i fjalës ndëshkim), *pasuria* përsëritet 26 herë dhe *varfëria* përsëritet 13 herë.

Fakte të tilla qartë tregojnë se Kur’ani është Fjala e Allahut, jo e njerëzimit. Ajo është shpallje e Allahut Profetit Muhammed (saas) dhe ka mbetur e pandryshuar që prej se u shpall.

Allahu shpreh këtë veti superiore si vijon:

**E në qoftë se dyshoni në atë që Ne ia shpallëm gradualisht robit Tonë, atëherë silleni ju një kaptinë të ngjashme me të (Kur’anin) dhe thirrni (për ndihmë) dëshmitarët tuaj (zotërat) pos All-llahut, nëse jeni të sigurtë (në thëniet tuaja se Kur’ani nuk është prej Zotit). E mos e paçit bërë (deri më tash), e as që do ta bëni kurrë (edhe në të ardhmën), atëherë ruajuni Zjarrit, lëndë e të cilit janë njerëzit dhe gurët, që është i përgatitur për mosbesimtarët. (Sure Bekare: 23-24)**

**Thuaj: “Edhe sikur të bashkoheshin njerëzit dhe xhinët për të sjellë të ngjashëm me Kur’anin, ata nuk do të mund të bënin si ky sado që do ta ndihmonin njëri - tjetrin”. (Sure Isra: 88)**

# ALLAHU ËSHTË I VETMI GJYKUES

*A thua mos po kërkojnë gjykimin e Kohës së  
Injorancës? Po për një popull që bindshëm  
beson, a ka gjykim më i mirë se ai i All-llahut?  
(Sure Maide: 50)*

**T**ë Dërguarit e Allahut dhe Kur’ani janë udhëzuesit e vetëm për besimtarët, siç lexojmë në:

**“Thuaj: ‘A të kërkojë Zot tjetër pos All-llahut, e Ai është Zot i çdo sendi?’” (Sure En’am: 164)**

Mirëpo, mosbesimtarët gjejnë dhe pasojnë udhëzues dhe udhëheqës tjerë pos Allahut, ndjekin ideologji dhe lëvizje të padrejta dhe kështu jetojnë në lajthitje të plotë. Por, kur vdesin dhe shohin mundimin e përjetshëm të Ferrit (Xhehenemit), do ta pranojnë këtë mashtrim të madh: **“Dhe thonë: ‘Zoti ynë, ne i dëgjuam udhëheqësit tonë dhe të parët tonë, por ata na shmangën nga Rruga e Drejtë’”** (Sure Ahzab: 67) dhe shfaqin pendimin e tyre.

Faktorët që përcaktojnë qëndrimet dhe besimet e shumicës së këtyre njerëzve, të cilët shtiren si të paditur për atë që do t'u ndodhë atyre pas vdekjes, janë rregullat, parimet dhe zakonet e shoqërisë. Duke i pasuar paraardhësit e tyre, shoqërinë që i rrethon apo udhëheqësit e tyre, këta njerëz devijojnë, sepse çdo mendim apo qëndrim që nuk është në pajtim me Kur'anin është i mangët.

Besimtarët, në anën tjetër, veprojnë në përputhje me urdhërat e Allahut dhe me përpikmëri ju shmangen të gjitha mendimeve dhe qëndrimeve të ndaluara, pa marrë parasysh kohën dhe vendin. Kurdo që bëjnë diçka apo sjellin një vendim, ata i referohen Kur'anit dhe Sunnetit të Profetit tonë (saas) dhe marrin parasysh urdhërin e Allahut në lidhje me atë situatë të veçantë. Ata sillen në pajtim me urdhërat e Kur'anit dhe jo në pajtim me trillet dhe dëshirat e tyre, zakonet e padrejta shoqërore apo zakonet e trashëguara. Vërtet, Allahu u thot besimtarëve:

**Dhe ky është Libër dobiprurës që Ne e zbritëm, përmbajuni atij dhe ruajuni ashtu që të mëshiroheni. (Sure En'am: 155)**

Ata që nuk e pranojnë Allahun si Gjykatësin e vetëm, që u kundërvihen urdhërave të Tij apo sajojnë gjykime të tjera pos të Tij devijojnë nga rruga e drejtë. Ata i konsiderojnë normat dhe zakonet e shoqërive të tyre më të shtrenjta se urdhërat e Allahut dhe qëndrojnë këmbëngulës dhe të paepur në këtë qëndrim. Edhe pse ndërgjegja e tyre pranon këtë të vërtetë, ata refuzojnë urdhërat e Allahut nga mendjemadhësia dhe fanatizmi. Në Kur'an, Allahu na njofton për njerëz të tillë, si vijon:

**E kur u thuhet atyre (idhujtarëve): “Pranoni atë që All-llahu e shpalli,” ata thonë: “Jo, ne ndjekim atë rrugë në të cilën i gjetëm**

**prindërit tanë.” Edhe sikur prindërit e tyre të mos kenë kuptuar dhe të mos jenë udhëzuar në rrugën e drejtë (ata do t’i pasonin)? (Sure Bekare: 170)**

**Ja pra, Ne nuk kemi dërguar para teje Paralajmërues (Pejgamber) në ndonjë vendbanim, që të mos i ketë thënë paria e pasur e tij: “Ne i gjetëm të parët tanë në këtë fé dhe ne jemi të orientuar gjurmëve të tyre.” Thuaj: “A edhe nëse ju kam sjell rrugë më të mirë nga ajo që i gjetët të parët tuaj?” Ata thonë: “Ne nuk i besojmë asaj me çka ju jeni dërguar!” (Sure Zukhruf: 23-24)**

Ky qëndrim vetëm se pengon njerëzit të përqafojnë Islamin dhe të besojnë në Allahun. Për shembull, Faraoni dhe krerët e popullit të tij thanë: **“A keni ardhur te ne të na largoni nga ajo që adhuruan baballarët tonë dhe të bëheni sundues në tokë? Ne nuk ju besojmë.** (Sure Jusuf: 78), kur Profeti Musa (as) dhe vëllau i tij Profeti Harun (as) i thirrën ata që të adhurojnë Allahun dhe t’i nënshtrohen Atij.

Në të njëjtën mënyrë, populli i Profetit Shuajb (as) pyeti: **“O Shuajb, a namazi yt po të thotë të na urdhërosh që ta braktisim atë që adhuruan prindërit tonë, ose të mos punojmë me pasurinë tonë ashtu si të dëshirojmë?”** (Sure Hud: 87), dhe pastaj kundërshtuan. Siç pohojnë këto vargje, njerëzit e thirrur në rrugën e Allahut nga ana e Profetëve gjithmonë përgjigjen: “Argumenti juaj nuk është në pajtim me rrugën që baballarët dhe stërgjyshërit tonë pasuan.”

Në çdo kohë, njerëzit reagues ndaj udhëzimeve të Profetëve me armiqësi dhe kundërshtim dhe këmbëngulën në qëndrimin e tyre.

Pra, të gjithë Profetët thirrën njerëzit të adhurojnë Allahu, t'i nënshtrohen Atij, ta pasojnë në mënyrë të sinqertë fenë e Tij dhe ta adhurojnë vetëm Atë duke kërkuar vetëm kënaqësinë e Tij.

Profeti jonë (saas) gjithashtu i thirri njerëzit t'i nënshtrohen vetëm Allahut dhe t'i binden urdhërave të Tij. Kur'ani na tregon se në Ditën e Gjykimit, njerëzit do të jenë përgjegjës për bindjen apo mosbindjen ndaj urdhërave të Allahut. Në Kur'an, Allahu paralajmëron ata të cilët adhurojnë zotëra tjerë përveç Tij dhe sajojnë religjion të ri të shtrembëruar duke u mbështetur në trillet e tyre me këto fjalë:

**A mos kanë ata ortakë (zotëra ose idhuj) që u përcaktuan atyre fé, të cilën nuk e urdhëroi All-llahu? Po, sikur të mos ishte fjala vendimtare (e All-llahut që shpërblimi dhe ndëshkimi të jenë në ahiret), do të kryhej dënimi mbi ta, e megjithatë, mohuesit do të kenë dënim të dhimbshëm. (Sure Shura: 21)**

Në një varg tjetër, Zoti ynë urdhëron:

**Po a nuk u mjaftoi atyre që Ne ta shpallëm Librin, i cili u lexohet atyre? E s'ka dyshim se kjo është dhuratë e përkujtim për njerëz që duan të besojnë". (Sure Ankebut: 51)**

Siç pohojnë këto vargje, disa prej atyre që refuzojnë udhëzimin e të Dërguarve bëjnë ashtu në emër të feve të rrejshme të sajuara nga njeriu dhe akuzojnë të Dërguarit për shtrembërim të kësaj feje. Ndryshe, duke e konsideruar argumentin e Allahut dhe të Dërguarin e Tij si të pamjaftueshëm, ata sajojnë fe të rrejshme. Mirëpo, qëndron fakti se Kur'ani që na e zbriti Allahu mjafton për njerëzit.

Besimtarët nuk merakosen për besimin dhe praktikat e lidhura me besimin e njerëzve tjerë, sepse ata i kushtojnë vëmendje vetëm urdhërave të Allahut dhe zakoneve të Profetit tonë (saas). Shpallja e

Kur'anit u dha fund besimeve dhe praktikave të padrejta të shumë njerëzve. Profeti ynë (saas), që nuk përfilli akuzat dhe armiqësinë e njerëzve, u mbështet fuqishëm në Allahun dhe Kur'anin. Në ditët tona, besimtarët duhet të mbështeten fuqishëm në Allahun, Kur'anin dhe Sunnetin e Profetit tonë (saas) dhe kurrë të mos kërkojnë rrugë tjetër pos asaj të Kur'anit.

## **Praktikat e shumicës së njerëzve janë kryesisht të mangëta**

Njëra prej ideve të gabuara më të mëdha e atyre që pasojnë mendimin e shumicës, që nuk përfillin vendimet e Allahut dhe kështu janë larg prej vlerave të Islamit është besimi i gabuar që “shumica gjithmonë përfaqëson të vërtetën.” Siç lexojmë në Kur'an, shumica e njerëzve nuk janë në rrugë të drejtë: **Në qoftë se u bindesh shumicës (mohuese që janë) në tokë, ata do të largojnë ty nga rruga e Allahut. Ata nuk ndjekin tjetër vetëm supozime dhe nuk janë tjetër vetëm se rrenacakë.** (Sure En'am: 116).

Poqese vendimet e shumicës nuk janë në pajtim me Kur'anin, ato nuk pasqyrojnë të vërtetën, sepse natyra e drejtë e një lëvizjeje nuk përcaktohet prej asaj se sa njerëz e pasojnë atë. Ky varg poashtu pohon se mendimet e shumicës së njerëzve mbështeten në supozime dhe prandaj largojnë shumë njerëz nga rruga e drejtë.

Largimi nga urdhërat e Allahut për t'iu bashkangjitur vendimeve të shumicës i bën ata humbës si në këtë botë ashtu edhe në botën tjetër, sepse ata mbeten krejtësisht të vetmuar: **“Ata shkatërruan vetveten dhe u shkoi huq trillimi që e bënin.”** (Sure A'raf: 53).



Ndërrimi i shpalljes së Allahut me një trillim bën që njerëzit të vuajnë zhgënjim të madh:

**E kush është më mizor se ai që trillon për All-llahun? Të tillët paraqiten para Zotit të tyre, e dëshmitarët thonë: “Këta ishin të cilët gënjyen ndaj Zotit të tyre, pra mallkimi i All-llahut qoftë kundër mizorëve!” (Sure Hud: 18)**

**E kush është më mizor se ai që shpif gënjeshtër ndaj All-llahut, ose përgënjeshton të vërtetën pasi t’i ketë ardhur ajo? Po, a nuk është Xhehennemi vend për jobesimtarët? (Sure Ankebut: 68)**

Në anën tjetër, besimtarët i nënshtrohen sinqerisht urdhërit të Allahut. Përsosmëria morale pasuese e tyre shpjegohet në vargjet në vijim:

**Zoti ynë ka përfshirë me diturinë e vet çdo send, ne ju kemi mbështetur All-llahut. Zoti ynë, vendos mes nesh dhe mes popullit tonë gjykimin tënd të drejtë, se Ti je më i miri gjykatës. (Sure A’raf: 89)**

**Unë nuk mund të largoj prej jush asnjë send nga caktimi i All-llahut, vendimi nuk është i tjetërkujt vetëm i All-llahut, vetëm Atij iu kam mbështetur dhe vetëm Atij le t’i mbështeten ata që besuan. (Sure Jusuf: 67)**

**Thuaj: “O All-llah, Krijues i qiejve e i tokës, Njohës i të fshehtës edhe i të dukshmës, Ti je që gjykon mes robërve Tu për atë që ata kundërshtoheshin”. (Sure Zumer: 46)**

# ATA QË GJYKOJNË NË EMRIN E ALLAHUT

*A mos kanë ata ortakë (zota ose idhuj)  
që u përcaktuan atyre fé,  
të cilën nuk e urdhëroi All-llahu?  
(Sure Shura: 21)*

**S**iç u bë fjalë më heret, disa njerëz sjellin vendime të padrejta që nuk kanë asgjë të përbashkët me Islamin, përcaktojnë çka është e ligjshme dhe e paligjshme dhe shpallin atë që Allahu e ka shpallur të ligjshme si të paligjshme dhe anasjelltas. Në ndërkohë, ata ndryshojnë origjinalitetin dhe thelbin e fesë dhe sajojnë “një fe të rrejshme të sajuar prej njeriut” me besimet dhe praktikatat e veta. Shumë njerëz, të cilët nuk e njohin Kur’anin dhe Islamin, dështojnë të njohin natyrën e padrejtë të kësaj “feje” dhe kështu mashtrohen dhe e pasojnë atë në mënyrë të pandërgjegjshme. Në këtë mënyrë ata të cilët vendosin urdhëra në emër të Allahut çojnë njerëzit në gjynah dhe kundërshtim. Kur’ani përshkruan gjendjen e tyre si vijon:

Në të vertetë, një grup prej tyre janë ata që pështjellojnë gjuhët e tyre kur lexojnë librin (për të deformuar kuptimin) ashtu që ju të mendoni se ajo (shprehje) është nga Libri, po ajo nuk është nga Libri. Madje thonë: “Kjo është nga All-llahu,” por ajo nuk është nga All-llahu. Ata duke ditur thonë gënjeshtër për All-llahun. (Sure Ali Imran: 78)

Disa shoqëri të cilat nuk e përqafojnë fenë e drejtë të Allahut dhe këmbëngulin në besimet e tyre të trashëguara madje shkojnë aq larg sa të bëjnë shpifje për Allahun. Pasiqë ata as që e fusin në punë urtësinë dhe ndërgjegjen e tyre dhe as nuk din ta vlerësojnë shtrirjen e dëturisë së Allahut, ata mbeten pa asnjë arsyetim që do t’i udhëzojë ata drejt të vërtetës. Dhe kështu ata shpikin shumë besime që janë të papajtueshme me Kur’anin dhe çojnë të paditurit në rrugët e padrejtësisë. Ata bëjnë atë që është e ligjshme të paligjshme dhe anasjelltas dhe bëjnë akuza të pabaza, siç lexojmë në vargjet në vijim:

**Dhe sipas bindjes së tyre ata thonë: “Këto kafshë dhe këto bimë janë të ndaluara. Askush nuk mund të ushqehet me to, përveç ata, të cilëve ne ua lejomë; këto janë kafshë që është e ndaluar t’u hipet; këto janë kafshë që gjatë therrjes së tyre nuk përmendin emrin e All-llahut, duke shpifur ndaj Tij. Ai do t’i ndëshkojë ata për shpifjet e tyre. Madje ata thonë: “Çka është në barqet e këtyre kafshëve është vetëm për mashkujt tanë, e ndaluar për gratë tona. E nëse (fruti në bark) ishte i ngordhur, ata (mashkuj e femra) ishin të barabartë në të. Ai (All-llahu) do të ndëshkojë cilësimin e tyre të rrejshëm. Ai është i përsosur në punët e Tij, i dijshtëm për krijesat e Tij. S’ka dyshim se kanë dështuar keq ata që mbytën fëmijët e tyre nga mendjehhtësia e pa kurrfarë dije dhe ata që**

**duke i shpifur Zotit, shpallën të ndaluar atë që Zoti u kishte dhuruar. Ata kanë humbur rrugën e drejtë dhe prej fillimit nuk ishin të udhëzuar. (Sure En'am: 138-140)**

Prandaj, ata të cilët merren me aktivitete të tilla njoftohen për mënyrën se si do të ndëshkohen në Ahiret dhe për faktin se nuk mund ta shmangin atë. Në Suren En'am, Allahu jap shembullin në vijim në lidhje me mizorinë që kryejnë këta njerëz “pa kurrfarë dijenie”

**Ai (krijoi) edhe nga devet dy (lloje) dhe nga lopët dy (lloje). Thuaj: “A dy meshkujt i ka ndaluar, a dy femrat, ose çka mban mitra e dy (llojeve të tyre) femrave? A mos ishit të pranishëm kur All-llahu ju porositi me këtë (hallall apo haram)?” E kush është më mizor se ai që trillon rrenë për All-llahun dhe ashtu t'i humbë njerëzit në mungesë të dijes. All-llahu nuk vë në rrugë të drejtë mizorët. (Sure En'am: 144)**

Këto vargje bëjnë të qartë gjithashtu se shumica e njerëzve kanë prirje të gjykojnë në emër të Allahut dhe ia mveshin ato gjëra për të cilat nuk kanë kurrfarë dijenie fesë. Duke qenë kështu, Zoti ynë, I Cili e njeh më së miri natyrën njerëzore, paralajmëron njerëzimin kështu: “Mos i thoni asaj (rrenës) që gjuhët tuaja thonë: ‘Kjo është e ligjshme e kjo është e paligjshme,’ e të shpifni rrenë ndaj All-llahut. Vërtet, ata që shpifin rrenë ndaj All-llahut, nuk kanë shpëtim. (Sure Nahl: 116) Në Suren Saffat, në anën tjetër, Allahu i pyet këta njerëz:

**Po ç'keni ju kështu? Si po gjykoni ashtu? A nuk jeni duke menduar? A mos keni ju ndonjë argument të sigurt? Silleni pra, Librin tuaj, nëse e flisni të vërtetën! (Sure Saffat: 154-157)**

Allahu është i vetmi gjykues, dhe Kur'ani përcjellë gjykimet/vendimet e Tij në formën më të qartë dhe më të kuptueshme. Allahu tërheq një vijë absolute midis asaj që është e ligjshme dhe e paligjshme dhe qartëson gjithçka që ka të bëjë me këto gjykime/vendime në mënyrë që asgjë të mos mbetet e hapur për t'u vënë në dyshim. Njerëzit mund të përcaktojnë nëse një vendim është i drejtë apo jo duke iu referuar Kur'anit dhe Sunnetit të Profetit tonë (saas). Kjo është mëshirë dhe lehtësi e madhe që Allahut ia dhuroi njerëzimit. Me të vërtetë, Profeti ynë (saas) pohon se Kur'ani është udhëzuesi dhe burimi i vetëm që i nevojitet njerëzimit:

*Ju kam lënë atë që, për sa kohë që i përmbaheni, kurrë s'do t'ju lë të devijoni pas meje: Librin e Allahut, një Litar që shtrihet prej qiejve në Tokë dhe Ahl al-Bayt-in tim. (Tirmidhiu)*

Kur'ani u drejtohet njerëzve të të gjitha kohërave. Për këtë arsye, pohimet e tij se Allahu është i vetmi gjykues dhe se ata që pretendojnë të gjykojnë në emrin e Tij do të përjetojnë fund të keq meritojnë që të mendojnë seriozisht për to. Kur'ani ofron shpjegim të hollësishëm për fetë dhe besimet e rrejshme të popujve të kaluar të sajuara nga njeriu. Në ditët tona, disa njerëz formulojnë gjykime të mangëta dhe shpjegim të paarsyeshëm në emër të fesë, pasi që ata nuk pasojnë udhëzimin Hyjnor të Kur'anit dhe të Sunnetit të Profetit tonë (saas). Në vend të kësaj, ata përpiqen të mbështesin gjykimet e tyre mbi atë që ata dëgjojnë apo shohin. Për shembull, shumë njerëz gënjejnë në bisedat e tyre të përditshme, edhe pse Kur'ani pohon se një praktikë e tillë është mëkat që do të ndëshkohet në Ahiret. Si alternativë, ata konstatojnë se “gënjeshttrat nga nevoja” janë të

falshme. Por ky është një iluzion i madh, sepse Allahu shpalli çdo lloj gënjeshtre si mëkat.

Apo, dikush që nxitë njerëzit në veprime që Allahu nuk i pëlqen mundet padrejtësisht të pretendoj se mbanë përgjegjësinë për mëkatin që pason. Por Allahu e bën të qartë se kjo nuk është e mundshme: **“Asnjë mëkatar nuk do të bartë mëkatin e tjetrit.”** (Sure Fatir: 18)

Rrjedhimisht, ata të cilët pohojnë se jetojnë në pajtim me vendimet e Allahut duhet t'i binden këtij urdhëri dhe t'i shmangen çfarëdo besimi apo qëndrimi që bie në kundërshtim me Kur'anin dhe Sunnetin e Profetit tonë (saas). Për më tepër, Kur'ani na njofton se ata që e pasojnë fenë e tyre të sajuar dhe braktisin shpalljen e Allahut poashtu akuzojnë të Dërguarit e Tij për shtrembërim të fesë dhe për të qenit gënjeshtarë. Në një varg lexon si vijon:

**Ata (idhujtarët) habiten, ngase u erdhi Paralajmëruesi (Pejgamberi) nga mesi i tyre, e mosbesimtarët thonë: “Ky është magjistari i rremë. A mendon ai t'i bëjë zotërat Një Zot? Vërtet, kjo është gjë shumë e çuditshme!”** Paria nga mesi i tyre shkoi duke i thënë njëri-tjetrit: **“Vazhdoni të jeni të qëndrueshëm në adhurimin e zotërave tuaj, se kjo është një gjë e kurdisur. Ne nuk kemi dëgjuar diçka të këtillë në fenë e fundit; kjo nuk është tjetër, pos një trillim! A mos atij, nga mesi ynë, iu zbrit Kur'ani (Përkujtuesi)? Jo, por ata janë në dyshim ndaj Kur'anit (Përkujtuesit) Tim, por për shkak se ende nuk e kanë shijuar dënimin Tim. (Sure Sad: 4-8)**

Njerëzit e tillë në përgjithësi pohojnë se veprojnë në emër të fesë, sepse ata nuk kanë dijeni për Islamin. Ata të cilët nuk përfillin vendimet e Allahut apo që i ndryshojnë ato sepse janë në kundërshtim me interesat e tyre personale nuk kanë respekt për Allahun dhe Librin e Tij. Të tillët dështojnë të vlerësojnë se Zoti ynë, i Cili krijoi gjithçka nga asgjëja, mund të bëjë çfarë të dojë Ai, se Dituria e Tij përfshinë gjithçka dhe se Ai i din fshehtësitë e njeriut dhe atë që është edhe më e fshehtë. Mirëpo, “dituria” e tyre është e kufizuar me paragjykim dhe bestytni.

Allahu e shfaqë Rrugën e Tij të Drejtë në Kur’an:

**Ti (Muhammed) praktiko atë që t’u shpall nga Zoti yt. S’ka zot, përveç Tij. Largohu prej idhujtarëve. (Sure En’am: 106)**

# MARRJA E KUR'ANIT SI UDHËRRËFYES

*Ai (Xhibrili) me urdhërin e All-llahut e zbriti  
Kur'anin në zemrën tënde, që është vërtetues i  
asaj që ishte më parë dhe udhërrëfytes e  
përgëzues për besimtarët.  
(Sure Bekare: 97)*

**K**ur'ani paraqet fakte të sigurta dhe në çdo rast përfshinë informacionin më të saktë që iu shpall Profetit Muhammed (saas). Për këtë arsye, ata të cilët e marrin atë dhe Sunnetin e Profetit tonë (saas) si kriterin e tyre të vetëm në jetë udhëzohen në Mëshirën e Allahut. Kjo veti e Kur'anit rrëfëhet si vijon:

**Është e vërtetë se ky Kur'an udhëzon për atë rrugë që është më e vërteta, e besimtarët që bëjnë vepra të mira i përgëzon se ata pa dyshim do të kenë shpërblim të madh. (Sure Isra: 9)**

**Ky (Kur'ani) është dritë e dijes për njerëz, është udhëzues e mëshirë për një popull që beson bindshëm. (Sure Xhathije: 20)**



Ata të cilët e përvetësojnë Kur'anin dhe rrugën e Profetit tonë (saas) si udhëzues kanë një mënyrë të jetesës që dallon shumë prej të tjerëve. Për shembull, ata nuk ndiejnë dëshpërim, shqetësim, mungesë shprese, mërazi apo kokëkrisje dhe nuk vuajnë nga bezdia apo paniku kur përballen me ngjarje të papritura, sepse Kur'ani dhe Sunneti i Profetit tonë (saas) i udhëzojnë ata gjithë kohën. Duke përkujtuar se jetojnë sipas fatit që Allahu ka zgjedhur për ta, ata i nënshtrohen Atij dhe kështu jetojnë në qetësi dhe reagojnë ndaj të gjitha ngjarjeve me urdhërat e Allahut në mendje. Çdo vendim, fjalë e shqiptuar dhe rresht i shkruar tregon për besnikërinë e tyre ndaj vlerave të Kur'anit. Duke qenë kështu, ata gjithmonë kanë ndërgjegje të pastër dhe e përjetojnë paqen shpirtërore që sjellë kjo gjendje. Allahu rrëfen për këtë në Suren Junus si vijon:

**O ju njerëz! Juve ju erdhi nga Zoti juaj këshilla (Kur'ani) dhe shërimi i asaj që gjendet në krahërorët tuaj (në zemra), edhe udhëzim e mëshirë për besimtarët. (Sure Junus: 57)**

Mirëpo, vetëm ata që e duan dhe i frikësohen Allahut, i nënshtrohen Atij sinqerisht dhe parapëlqejnë Ahiretin ndaj dynjasë dhe i kushtojnë vëmendje Kur'anit dhe mendojnë për vargjet e tij. Në një varg tjetër, Allahu na urdhëron si vijon:

**Ne nuk ta shpallëm Kur'anin për të munduar ty. Ta shpallëm vetëm si Këshillë (Përkujtim) për ata që frikësohen. (Sure Ta Ha: 2-3)**

Kjo çështje është poashtu një fshehtësi e rëndësishme e Kur'anit. Për ta kuptuar atë, gjithçka nevojitet është një qëllim i vendosur, një besim i thellë dhe sinqeriteti, në kundërshtim me nivelin e lartë të zgjuarsisë, sepse Allahu i udhëzon robërit e Tij të vërtetë, siguron se

ata përfitojnë nga Kur'ani dhe e arrijnë shpëtimin. Mirëpo, kjo Shpallje e Allahut njerëzimit i udhëzon vetëm ata të cilët e duan dhe ia kanë frikën Atij dhe i respektojnë kufizimet/ndalesat e Tij. Disa nga vargjet e rrefyera janë si vijon:

**Dhe (përkujtoju njerëzve) atë Ditë, kur në secilin popull do të sjellim dëshmitarë kundër tyre, e ty të sjellim dëshmitarë kundër atyre. Ne ty të shpallëm Librin sqarim për çdo send, udhëzim e mëshirë dhe myzhde për Muslimanët. (Sure Nahl: 89)**

**Thuaj; “Atë (Kur'anin) e solli “Ruhul Kudus” - shpirti i shenjtë - plot vërtetësi nga Zoti yt, për t'i përforcuar edhe më ata që besuan, dhe për të qenë udhërrëfyese e myzhde për Muslimanët. (Sure Nahl: 102)**

**Ato janë Ajete të Librit me plot urtësi të përsosur. E që janë udhëzim e mëshirë për ata që janë punëmirë. (Sure Lukman: 2-3)**

**O ju njerëz! Juve ju erdhi nga zoti juaj Këshilla (Kur'ani) dhe shërimi i asaj që gjendet në krahërorët tuaj (në zemra), edhe udhëzim e mëshirë për besimtarët. (Sure Junus: 57)**

Siç shpallin këto vargje, Kur'ani paralajmëron njerëzimin dhe udhëzon të gjithë Muslimanët që janë të përlulur dhe i respektojnë ndalesat e Allahut. Bediuzzaman Said Nursi, një dijetar Islamik i madh Turk, shkruan se Kur'ani është udhëzim për robërit e devotshëm të Allahut: *“Kur'ani i të Gjithëdijshmit është udhëzues për të vetëdijshmit dhe të ndërgjegjshmit, udhëzim për exhinët dhe njerëzit (dhe femrat), mësues i atyre që përpiqen ta arrijnë përsosmërinë dhe mësues i atyre që kërkojnë realitetin.”* (Bediuzzaman Said Nursi, *Përmbledhja Risale-i Nur*, “Letrat: Letra e 26-të”)

# KUR'ANI ËSHTË PËRKUJTUES PËR TË GJITHA BOTËRAT

*Ky (Kur'ani) nuk është tjetër vetëm se  
këshillë për botërat.  
(Sure Sad: 87)*

**G** jkimet e Kur'anit, Librit unik të urtësisë që Allahu e dërgoi si përkujtues për të gjitha botërat, do të vlejnjë deri në Ditën e Gjykimit. Mirëpo, disa njerëz jo të sinqertë të cilët sajojnë arsyetime për t' mos iu bindur gjykimeve të tij padrejtësisht pohojnë se Kur'ani i drejtohet vetëm një periudhe të caktuar dhe vetëm shoqërisë Arabe të asaj kohe. Sipas këndvështrimit të cekët të tyre, disa prej mendimeve të tij mund të mos merren parasysht.

Duke qenë se Kur'ani qëndron mbi gjithë kohërat dhe vendet, është përkujtues për të gjithë njerëzit për jetën e amshueshme dhe i thërret ata në rrugën e drejtë. Siç lexojmë: **“Dhe se ajo (shpallja) është lëvdatë e madhe për ty dhe për popullin tënd dhe për këtë**

**(lëvdatë) më vonë do të përgjigjeni.** (Sure Zukhruf: 44), dhe prandaj njerëzit do të thirren që të japin përgjegjësi për veprimet e tyre në Jetën e Përtejme (në Ahiret).

Me urtësinë e tij unike dhe superiore, informacioni që përcjellë për të kaluarën dhe të ardhmën, si edhe stili i tij, i cili mënjanon harresën dhe sjelljen e bërë të zakonshme, Kur'ani është Libër i pashoq/i pakrahasueshëm. Kjo veti unike vlen për të gjithë njerëzit të cilët janë krijuar që nga shpallja e tij dhe të cilët do të krijohen deri në Ditën e Gjykimit.

Citimi në vazhdim nga Bediuzzaman Said Nursi konstaton se urtësia e Kur'anit është e amshueshme:

*Njerëzit e të vërtetës dhe dijetarët këmbëngulës. Ata thonë: “Kur'ani është një thesar i pafund dhe i pashtershëm. Përveç nënshtrimit dhe pranimit të çështjeve të vendosura dhe të pakundërshtueshme, secila epokë pranon poashtu pjesën e saj të të vërtetave të fshehta të saj, në formën e një shtojce; nuk mund të futet pa leje në pjesën e një tjetre e cila është e fshehtë.” (Ibid., “Letra e 29-të”)*

Bediuzzamani, i cili gjithashtu përmendi ndikimin e Kur'anit në njerëz, e përshkruan këtë ndikim si vijon:

*Kjo është rinia e Kur'anit. Ai ruan freskinë dhe rininë e tij në secilën kohë sikurse të ishte shpallur rishtas. Në të vërtetë, Kur'ani duhet të ketë rini të përjetshme pasiqë, si adresë e para-përjetësisë, i drejtohet përnjëherë të gjithë njerëzve të secilës kohë.*

(Bediuzzaman Said Nursi, *Përmbledhja Risale-i Nur*, “Fjalët: Fjala e 25-të”)

*Vendimet dhe ligjet e Kur'anit janë aq bindëse dhe të bazuara sa që forcohen vazhdimisht me kalimin e shekujve. (Ibid.)*

Bediuzzamani më tutje konstaton se Kur'ani është një Libër i pashoq që nuk mund të zëvendësohet me asnjë libër tjetër:

*Kur'ani assesi as nuk ka – as nuk mund të ketë – asnjë të barabartë. Absolutisht asgjë nuk mund ta zërë vendin e kësaj mrekullie më madhështore. (Ibid., “Fjala e 13-të”)*

Për më tepër:

*Ai tregon stilin e tij madhështor, të bukur dhe original, të cilin askush s'mund ta imitojë, edhe pse e kënaq çdokend. Kalimi i kohës nuk bën që stili i tij të vjetërsohet; ai gjithmonë mbetet i freskët dhe i ri. Proza e tij dhe renditja e fjalëve janë aq mirë të rradhitura sa që është si i lartë ashtu edhe i këndshëm. Për falltarët dhe parashikuesit/profetizuesit tjerë të të Padukshmes, shfaqë natyrën e tij të mrekullueshme në njoftimet e tij të mrekullueshme në lidhje me të Padukshmen. Për historianët, ai shfaqë natyrën e tij të mrekullueshme duke dhënë informata në lidhje me ngjarjet e kohërave të kaluara, si edhe për ngjarjet e së ardhmës dhe për Mbretërinë (Jetën) e Ndërmjetme dhe për Ahiretin (Jetën e Përtejme). Për shkencëtarët social dhe politik, tregon natyrën e tij të mrekullueshme në parimet e tij të shenjta... Për njerëzit e pajisur me dijeni prej Allahut dhe me të vërtetat kozmike, ai tregon natyrën e mrekullueshme të të vërtetave të shenjta Hyjnore në Kur'an, përndryshe tregon për ekzistencën e kësaj natyre të mrekullueshme. Për Sufitë dhe të shenjtët tregon natyrën e tij të mrekullueshme në misteriet e fshehta të vargjeve të tij, të cilat pandërprerë ngriten dhe bien*

## MARRJA E KUR'ANIT SI UDHËRRËFYES

*sikurse valët në detin e Kur'anit. Dhe kështu me rradhë. Për secilën prej kategorive të njerëzve, hap një dritare dhe shfaqë natyrën e tij të mrekullueshme. Madje edhe njerëzit e rëndomtë, të cilët vetëm e dëgjojnë Kur'anin duke kuptuar pak nga domethënia e tij, vërtetojnë se nuk ka ngjashmëri me asnjë libër tjetër. (Nursi, “Letra e 19-të”)*

Përgjegjësia parësore e secilit person është t'i shërbej Allahut. Vetëm kthimi drejt Allahut me zemër të sinqertë dhe marrja e Kur'anit si udhërrëfyes e mundëson këtë. Secili person duhet ta marr këtë përgjegjësi dhe me vendosmëri ta përqafojë Kur'anin. Në Suren Hashr, Allahu rrëfen superioritetin e Kur'anit dhe shpjegon se çfarë përgjegjësie e madhe është që Kur'ani të merret si udhërrëfyes:

**Sikur Ne ta zbritnim këtë Kur'an mbi ndonjë kodër, do ta shihje atë të strukur e të çarë prej frikës nga All-llahu. Këta janë shembuj që ua shkoqisim njerëzve, që ata të mendojnë. (Sure Hashr: 21)**

# KUR'ANI ËSHTË KRITER QË BËN DALLIMIN NË MES TË SË DREJTËS DHE TË GABUARËS

*Udhërrëfim për njerëz, e zbriti edhe Furkanin  
(dalluesin e së vërtetës nga gënjeshtër).*

*S'ka dyshim se ata që mohojnë argumentet e  
All-llahut i pret ndëshkimi i rreptë.*

*All-llahu është ngadhënjyes, shpagimtar.  
(Sure Ali Imran: 4)*

**N**ë Kur'an, Allahu këshillon njerëzit dhe u tregon atyre rrugën e drejtë. Kur'ani është burimi i vetëm që i udhëheq njerëzit drejt diturisë së drejtë të Allahut, vlerave të Islamit, se si të jetohej në mënyrën me të cilën Allahu është i kënaqur dhe kriter absolut që dallon të drejtën nga e gabuara. Për këtë arsye, njëri prej emrave të Kur'anit është "Furkan": libër që bën dallimin në mes të së drejtës dhe të gabuarës.

Në këtë botë, njerëzit kanë besimet, synimet, vlerat, mendimet dhe botëkuptimin e tyre për jetën. Mirëpo, gjykimet që Allahu shpallë në Kur'an janë të vetmet vlera që mund të konsiderohen si të drejta dhe të sakta. Siç shpallë Allahu në Suren Bekare: 120: **“Udhëzimi i Allahut është udhëzim i drejtë.”** Prandaj, synimet dhe mënyrat e sajua nga njerëzit për të jetësuar interesat e tyre personale kurrë nuk mund t'i udhëzojnë ata drejt të vërtetës dhe shpëtimit. Qëllimi i ekzistencës së njerëzimit dhe si të arrihet kjo, parimet ideale morale dhe sjellja e mirë që duhet të tregohet gjatë gjithë jetës së njeriut, mënyra se si të jetohej një jetë e shëndoshë fizike dhe shpirtërore, momenti i vdekjes dhe ajo që do t'i ndodhë shpirtit të njeriut në Ditën e Gjykitimit – të gjitha këto rrëfohen në Kur'an.

Njeriu duhet ta lexojë Kur'anin me vëmendje për të përfituar prej tij dhe për të qenë i udhëzuar drejtë:

**Atyre, të cilëve Ne u dhamë Librin dhe të cilët e lexojnë drejtë atë ashtu si duhet, ata e besojnë atë (Kur'anin). E ata që e mohojnë atë, të tillët janë ata që dështuan (në dynja e në ahiret). (Sure Bekare: 121)**

Leximi i Kur'anit ashtu siç duhet të lexohet bëhet i mundshëm kur njerëzit ndiejnë dashuri dhe frikë për Allahun dhe e pasojnë atë. Ata të cilët e lexojnë Kur'anin në këtë mënyrë i nënshtrohen çdo gjykimi të Kur'anit dhe i përkushtohen krejtësisht zbatimit të përpiktë të çdo vargu.

Duke pasur parasysh këtë, ata të cilët e pasojnë atë i mbështesin të gjitha vendimet e tyre në dritën e Kur'anit dhe të Sunnetit të Profetit tonë (saas). Duke iu falënderuar kësaj vetie, besimtarët mund të bëjnë



dallimin në mes të së drejtës dhe të gabuarës dhe të sjellin vendimin më të mirë. Siç e bën poashtu të qartë vargu: **“Udhëzimi i drejtë është bërë qartë i dallueshëm nga lajthitja/mëkati”** (Sure Bekare: 256), besimtarët nuk përpiqen të gjejnë një rrugë të mesme në mes të vlerave të Kur’anit dhe jetesës në mosdije; në vend të kësaj, ata i binden plotësisht dhe me siguri Kur’anit, i cili është rruga më e drejtë. Allahu i urdhëron besimtarët të mbështeten fuqishëm në Kur’an, si vijon:

**Andaj, ti përmbaju asaj që po të shpallet, e s’ka dyshim se ti je në rrugë të drejtë. Dhe se ajo (shpallja) është këshillë për ty dhe për popullin tënd dhe për të më vonë do të përgjigjeni. (Sure Zukhruf: 43-44)**

Ata të cilët largojnë vetveten nga shpalljet e Allahut dhe këmbëngulin në mosbesim kanë zgjedhur mundim dhe vuajtje si në këtë botë ashtu edhe në atë të ardhmën, sepse mënyra e jetesës që Allahu na urdhëron që ta jetojmë është ajo që më së shumti i shkon për shtati natyrën së njeriut. Prandaj, ata të cilët nuk jetojnë në pajtim me Kur’anin kurrë nuk mund të arrijnë qetësi dhe lumturi të vërtetë, sepse e kanë braktisur një mënyrë të jetesës që është në pajtim me vet natyrën e tyre. Për të arritur shpëtimin dhe lumturinë si në këtë botë ashtu edhe në tjetrën, njerëzit duhet ta mësojnë fenë e vërtetë, urdhërat e Zotit tonë dhe t’i binden me përpikmëri Kur’anit. Vërtet, Allahu paralajmëron njerëzit kështu:

**A thua mos po kërkojnë gjykimin e Kohës së Injorancës, po për një popull që bindshëm beson, a ka gjykim më i mirë se ai i Allahut? (Sure Maide: 50)**

**Po a nuk u mjaftoi atyre që Ne ta shpallëm Librin, i cili u lexohet atyre, e s'ka dyshim se kjo është dhuratë e përkujtim për njerëzit që duan të besojnë". (Sure Ankebut: 51)**

Përcaktimi i saktë, komentet, arsyetimi/gjykimi dhe rekomandimet e njerëzve të cilën jetojnë në pajtim me Kur'anin dhe aftësia e tyre për të gjetur zgjidhje për problemet me të cilat ata përballen burojnë drejtpërdrejt prej Kur'anit. Për këtë arsye, ata kanë gjithnjë të drejtë, janë gjithnjë të drejtë dhe të urtë.

Gjendja e atyre të cilët dështojnë t'i binden Kur'anit tregohet si në vazhdim:

**A mos kërkojnë ata (ihtarët e librit) fe, pos fesë së shpallur nga All-llahu? E Atij i është dorëzuar gjithë ç'ka në qiej e në tokë, me dashje apo pa dashje dhe te Ai kthehen. (Sure Ali Imran: 83)**

**E, kush kërkon fe tjetër përveç fesë Islame, atij kurrsesi nuk do ti pranohet dhe ai në botën tjetër është nga të dëshpëruarit. (Sure Ali Imran: 85)**

**Feja e pranueshme tek All-llahu është Islami, e atyre që u është dhënë Libri, pasi mësuam për të vërtetën, vetëm nga zilia mes vete kundërshtuan. E kush mohon argumentet e All-llahut, le ta dijë se All-llahu shpejt do t'i jap llogarinë. (Sure Ali Imran: 19)**

Për këto arsye, njerëzit duhet t'i braktisin të gjitha besimet e rrejshme dhe të marrin si shembull vetëm Kur'anin dhe Sunnetin e Profetit tonë (saas). Përndryshe, ata do të pushtohen nga pikëllimi dhe pendimi i madh në Ahiret dhe do të pranojnë një ndëshkim të rëndë.

# ALLAHU SQARON ÇDO GJËNË KUR'AN

*Ne ty të shpallëm Librin sqarim për çdo send,  
udhëzim e mëshirë dhe myzhde për Muslimanët.  
(Sure Nahl: 89)*

**P**ër të nxjerrur njerëzit nga errësira për në dritë, Allahu na dërgoi Kur'anin për të sqaruar çdo çështje dhe për të ofruar çdo zgjidhje. Siç lexojmë:

**Ne ty të shpallëm Librin sqarim për çdo send, udhëzim e mëshirë dhe myzhde për Muslimanët. (Sure Nahl: 89)**

Në anën tjetër, Allahu shpall: **“Asgjë nuk kemi lënë pas dore nga evidence (në Libër). Më në fund te Zoti i tyre do të tubohen.”** (Sure En'am: 38). Në Kur'an, Allahu shpjegon çdo gjë në mënyrën më të përsosur, më të urtë dhe më të ngjeshur. Kjo është një shfaqje e Mëshirës së Allahut për robërit e Tij. Në Kur'an, Ai na informon për parimet themelore të besimit të vërtetë, për shumë çështje në lidhje me jetën në këtë botë dhe në tjetrën, parimet ideale morale për besimtarë dhe shumë çështje tjera që udhëzojnë njerëzimin. Allahu e prezanton Vetën tek ne

përmes Kur'anit, shpjegon se Ai krijoi çdo gjë prej asgjëje, se Ai është i lartësuar mbi çdo gjë, se Ai sheh dhe dëgjon fshehtësitë dhe çfarë është edhe më e fshehtë dhe se Ai din çdo gjë.

Kur'ani na jap një shpjegim të hollësishëm për arsyen dhe mënyrën se si u krijua njeriu, mënyrën e jetës që fiton kënaqësinë e Allahut, mënyrat e adhurimit, një përshkrim të përsosmërisë morale, mënyrat për të qëndruar i shëndoshë fizikisht dhe mentalisht dhe se si të trajtohen problemet, nevojat e ngutshme dhe njerëz të ndryshëm në shoqëri. Ai poashtu përmban dëshmi të fakteve shkencore, dituri në lidhje me jetën e përditshme, për problemet shoqërore, Ditën e Gjykimit, Parajsën dhe Ferrin dhe shumë çështje tjera. Me fjalë të tjera, Kur'ani ofron gjithë diturinë themelore që mund t'ju nevojitet njerëzve në çdo kohë. Siç lexojmë:

**Kështu Ne e shpallëm këtë Kur'an Arabisht dhe përsëritëm në të vërejtjet, në mënyrë që ata të ruhen ose që ai (Kur'ani) t'u sjellë atyre përvojë mësimi. (Sure Ta Ha: 113)**

**Në këtë Kur'an Ne shtruum çdo lloji shembulli për hirë të njerëzve, por njeriu (jobsimtari), më shumë se çdo tjetër është kundërshtar. (Sure Kehf: 54)**

Në Kur'an, Allahu i bën me dije të gjithë njerëzit se ata duhet t'i binden gjykimeve të Tij pa kushtëzime, ta marrin Atë si shokun dhe mbrojtësin e tyre të vetëm dhe ta bëjnë përfitimin e kënaqësisë së Tij dhe të Parajsës qëllimin e tyre të vetëm në jetë. Për ata të cilët jetojnë në pajtim me Kur'anin, Kur'ani është i vetmi kriter dhe rruga e Profetit tonë (saas) e vetmja rrugë që vlen për t'u ndjekur. Kur'ani na bën me dije se Muslimanët e vërtetë të të gjitha epokave kanë braktisur fenë e rrejshme të shoqërisë së tyre dhe i janë kthyer Allahut dhe urdhërave të

Tij. Për shembull, Kur'an i rrëfen për mënyrën se si Shokët e Shpellës, një grup i besimtarëve të rinjë, u dënuan dhe u kërcënuan me vdekje sepse nuk pranuan fenë e stërgjyshërve të tyre dhe kërkuan strehim në një shpellë (Sure Kehf: 13-16). Kthimi i Profetit Jusuf (as) tek Allahu është një shembull për këtë:

**Unë kam braktisur fenë e një populli që nuk e beson All-llahun as botën tjetër, e ata ishin jobesimtarë. Unë e ndoqa fenë e prindërve të mi: Ibrahimit, Is-hakut, Jakubit. Neve nuk na takoi t'i përshkruajmë kurrë një send shok All-llahut. (Sure Jusuf: 37-38)**

Në kuptimin shpirtëror, braktisja e fesë së rrejshme të shoqërisë nënkupton ndarjen në tërësi prej pasuesve të asaj feje. Me fjalë të tjera, nënkupton se një person është pastruar plotësisht prej mënyrës së mëparshme të adhurimit, besimit, gjykimeve të vlerës, mënyrës së arsyetimit, kodeve morale, zakoneve dhe traditave, mënyrave të sjelljes dhe të jetesës që bien ndesh me Kur'anin, edhe pse shoqëria e tyre ende pason gjëra të tilla dhe që e kanë përqafuar shpalljen e Allahut si pikën themelore të referimit.

Allahu është i kënaqur me Islamin si fe për robërit e Tij. Për atë arsye, Ai zbriti Kur'anin si udhëzim për ta dhe e bëri jetën e Profetit tonë (saas) shembull. E vetmja rrugë e vërtetë dhe e drejtë është rruga e Allahut, siç përshkruhet në Kur'an. Të gjitha rrugët tjera janë të padrejta dhe të gabueshme dhe mbështeten në fanatizëm, herezi dhe hamendje. Prandaj, njerëzit mund të shpresojnë që të jenë të trajtuar mirë në shikimin e Allahut, me kusht që ata t'i binden në përpikmëri urdhërave të Tij, të bëjnë vepra të mira për të fituar kënaqësinë e Tij dhe të ndjekin gjurmët e Profetit tonë (saas).

Siç na bën me dije Allahu në Kur'an, fjalët e Zotit tonë janë “të

përkryera me vërtetësi dhe drejtësi,” dhe vetëm ata të cilët pasojnë Kur'anin dhe Sunnetin e Profetit tonë (saas) mund të arrijnë diturinë më të vërtetë dhe më të saktë. Nuk ka “grykues” tjetër pos Allahut, siç theksohet në vargun në vazhdim:

**(Thuaj) “A pos All-llahut të kërkoj unë gjykatës (mes meje dhe juve)? Kur Ai është që zbriti Librin që qartëson çdo gjë? Atyre që u dhamë Librin e dinë se ai (Kur’ani) është i zbritur prej Zotit tënd saktësisht, pra mos u bë prej atyre që dyshojnë. Fjalët e Zotit tënd janë plot të vërteta (çka lajmërojnë) dhe plot të drejta (çka gjykojnë). S’ka kush që të mund të ndryshoj fjalët (vendimet) e Tij. Ai është që dëgjon e di. (Sure En’am: 114-115)**

Gjithashtu, Profeti ynë (saas) ka thënë se ai është burimi i vetëm të cilit të gjithë njerëzit duhet t’i drejtohen. Disa prej këshillimeve të tij i gjejmë në traditat profetike të dhëna në vazhdim:

*Kur’ani është një litar i fortë i Allahut, që domthënë se është ai një mjet i sigurt për t’u lidhur me Allahun dhe një statut i fortë i udhëzimit. Ai është rruga e drejtë. Kur’ani është e vërteta e qartë që nuk lejon që mendimet të devijojnë. (Tirmidhiu)*

*I Dërguari i Allahut ka thënë: “Këto zemra ndryshken, mu sikurse hekuri që ndryshket kur i hyn uji.” Dikush pyeti: “O i Dërguar i Allahut, si mund të pastrohen ato?” Ai tha: “Përkuajtimi i shumtë i vdekjes dhe leximi i Kur’anit.” (Bayhaqi; Manzoor No’mani, Ma’ariful Hadith (Pakistan), 85.)*

*Gëzohu, sepse me të vërtetë ky Kur’an – një pjesë e tij është në duart e Allahut dhe pjesa tjetër është në duart tuaja. Prandaj, përmbajuni atij, sepse kurrë nuk do të shkatërroheni apo të devijoni pas tij! (Musnad Ahmad).*

# TË JETUARIT SIPAS VLERAVE TË KUR'ANIT ËSHTË I LEHTË

*Ne Kur'anin e bëmë të lehtë për mësim,  
po a ka ndokush që merr mësim?  
(Sure Kamer: 17)*

Allahu zbriti Kur'anin si udhëzim për njerëzimin dhe komunikoi mënyrën më të thjeshtë dhe më të mirë që njeriu duhet të jetojë. Vargjet na japin lajmin e mirë se Islami është i lehtë për t'u praktikuar: **All-llahu me këtë dëshiron lehtësim për ju. Ai nuk dëshiron vështirësim për ju**" (Sure Bekare: 185).

Kur'ani është paralajmërim i qartë për njerëzit e të gjitha moshave dhe kulturave. Megjithatë, disa njerëz iu referohen burimeve të pasigurta, në vend të Kur'anit, gjë që bën që ata të besojnë gabimisht se Islami është i vështirë. Arsyeja kryesore që qëndron pas këtij qëndrimi është dituria e tyre jo e plotë për Islamin.

Në ditët tona, shumë njerëz mbeten krejtësisht të pavetëdijshëm për faktet e komunikuar nga Kur'ani, siç është ekzistenca e Ahiretit, jeta e amshueshme në Ferr, mirësitë e pakrahasueshme të Parajsës dhe këshillimet dhe paralajmërimet e Zotit tonë për njerëzimin. Mirëpo, Kur'ani u zbrit në mënyrë që njerëzit të mund ta lexonin dhe të paralajmëroheshin. Kur'ani shpallë se Allahu i tha Profetit (saas) të thot: “(Jam urdhëruar) ta lexoj Kur'anin” (Sure Naml: 92).

Njëra prej përgjegjësive më të rëndësishme të një Muslimani është ta lexojë dhe t'i bindet Kur'anit. Allahu bën që njerëzit të kuptojnë Kur'anin dhe vetëm ata të cilët janë të udhëzuar prej Tij mund ta kuptojnë kuptimin e plotë të vargjeve të tij. Ai poashtu premton udhëzim për robërit e sinqertë që i drejtohen Atij.

Ata të cilët pohojnë se Kur'ani është i vështirë për t'u kuptuar përpiqen që t'i ndalojnë njerëzit nga leximi i tij, që t'i drejtohen Allahut dhe që të jetojnë në pajtim me vlerat e tij. Mirëpo, Allahu shpall në shumë pjesë të Kur'anit se ai është i lehtë për t'u kuptuar:

**Ne të kemi shpallur ty (Muhammed) Argumente të Qarta dhe ato nuk i mohon askush, përveç atyre që kanë dalë respektit. (Sure Bekare: 99)**

**O ju njerëz, juve ju erdhi nga Zoti juaj argument i qartë dhe Ne ju zbritëm Dritë të Qartë. (Sure Nisa: 174)**

Veç Kur'anit, gjykimet dhe praktikat e tij janë poashtu shumë të lehta. Vargu në vijim është i vetëkuptueshëm:

**Ne nuk ta shpallëm Kur'anin për të munduar ty. Ta shpallëm vetëm këshillë (përkujtim) për atë që frikësohet. (Sure Ta Ha: 2-3)**

Parimet morale të Kur'anit janë e vetmja mënyrë e jetesës që i shkon për shtati natyrës njerëzore. Allahu, Krijuesi i njeriut nga



asgjëja, është Ai i Cili i di më së miri nevojat e njerëzve, mënyrat e adhurimit që ata mund të zbatojnë dhe rrugët që shpien drejt një jete të qetë dhe pa shqetësime. Për këtë arsye, Allahu na informon se Ai nuk i ngarkon njerëzit me më shumë se që ata mund të përballojnë:

**All-llahu nuk ngarkon askënd përtej mundësive të veta, atij (njeriut) i takon ajo që e fitoi dhe atij i bie ajo (e keqe) që e meritoi. “Zoti ynë, mos na dëno nëse harrojmë ose gabojmë! Zoti ynë, mos na ngarko neve barrë të rëndë siç i ngarkove ata para nesh! Dhe Zoti ynë, mos na ngarko me atë për të cilën nuk kemi fuqi! Na i shlyej mëkatet, na i mbulo të këqijat, na mëshiro. Ti je Mbrojtësi ynë, na ndihmo kundër popullit pabesimtar! (Sure Bekare: 286)**

Prej Mëshirës dhe Dhembshurisë së Tij të pafund për robërit e Tij, Allahu jap një shpjegim të hollësishëm për mënyrën e jetesës që do të dhurojë lumturi, paqe dhe qetësi për njerëzit. Për shembull, njerëzit natyrshëm e duan dashurinë, respektin, mëshirën dhe dhembshurinë dhe presin kujdes të tillë prej tjerëve. Ata i shmangen vrazhdësisë, të keqes dhe imoralitetit dhe natyrshëm i frikësohen ekspozimit të tyre. Ndjenja dhe shpresa të tilla janë frymëzim i Allahut për shpirtin e njeriut.

Pasiqë kjo është mënyra se si Allahu krijoi natyrën njerëzore, mënyra e jetës që është në pajtim me parimet morale të Islamit është jeta që ofron kënaqësi më të plotë për njerëzimin. Allahu e thekson këtë fakt në Suren Rum, si vijon:

**Përqendro veten tënde sinqerisht në Fenë, i larguar prej çdo të kote, (e ajo fé), feja e All-llahut në të cilën i krijoi njerëzit, s’ka ndryshim (mos ndryshoni) të asaj natyrshmërie të krijuar nga**

**All-llahu, ajo është feja e drejtë por shumica e njerëzve nuk e dinë. (Sure Rum: 30)**

Kur'ani shpall në disa vende se feja e përshkruar në Kur'an është më e lehta në shumë aspekte, si vijon:

**All-llahu me këtë dëshiron lehtësim për ju. Ai nuk dëshiron vështërsim për ju. (Sure Bekare: 185)**

**Sa i përket atij që besoi dhe bëri vepra të mira, atij i takon shpërblimi më i mirë (Xhenneti) dhe atij nga ana Jonë do t'i bëjmë lehtësi (në jetë). (Sure Kehf: 88)**

**Ne Kur'anin e bëmë të lehtë për mësim, po a ka ndokush që merr mësim? (Sure Kamer: 17)**

**Ai ju zgjodhi ju (ju përcaktoi për të luftuar në rrugën e Tij) dhe nuk ju obligoi në fé me ndonjë vështirësi, në fenë e babait tuaj, Ibrahimit. (Sure Haxhxh: 78)**

Sunneti i Profetit tonë (saas) është poashtu i lehtë për t'u praktikuar. Profeti jonë (saas), i cili mori Kur'anin si udhëzues të tij, ka thënë: *“Lehtëso (çështjet fetare për njerëzit) dhe mos i bën (gjërat) të vështira. Dëgjoni njëri tjetrin dhe mos u grindni (në mes vete).” (Bukhari dhe Muslimi).*

Të gjithë Muslimanët janë përgjegjës për ta paraqitur lehtësinë e Islamit (që është pikërisht thelbi i tij), duke i pajtuar zemrat e njerëzve me Kur'anin dhe Islamin, duke i informuar njerëzit për Kur'anin dhe Sunnetin e Profetit tonë (saas) dhe duke i bërë ata udhëzues të vetëm në jetën e njeriut.

# BINDJA NDAJ KUR'ANITLARGON BARRËN E NJERIUT

*All-llahu dëshiron t'ju lehtësoj (dispozitat), e  
megjithatë njeriu është i paaftë (për të  
përballuar epshet).  
(Sure Nisa: 28)*

**S**ecili njeri vie në jetë dhe rritet me Vullnetin e Allahut dhe ka nevojë për mbrojtjen e Tij në secilën fazë të jetës. Allahu është mbrojtësi, udhëzuesi dhe mbështetësi i vetëm i të gjithë njerëzve, i Gjalli, i Cili është Krijuesi i çdo gjëje. Vargu në vazhdim e pohon këtë fakt:

**O ju njerëz, ju keni nevojë për All-llahun e All-llahu nuk ka nevojë për ju; Ai është i falënderuari. (Sure Fatir: 15)**

Allahu, Krijuesi i gjithësisë dhe të gjitha qenieve, qofshin të gjalla apo të vdekura, zbriti Kur'anin si mëshirë për njerëzimin. Mirëpo, disa njerëz sajojnë arsyetime të ndryshme për të mos jetuar sipas vlerave të tij. Njëra prej këtyre është ideja e gabuar se parimet morale

Islame disi kufizojnë mënyrën e tyre të zgjedhur të jetës. Por ky është një mashtrim i madh, sepse ata të cilët jetojnë në shoqëritë që nuk ndjekin parimet morale të Kur'anit përjetojnë ankth të madh, vështirësi dhe kufizime, ndërsa parimet morale të Kur'anit paraqesin një jetë të lumtur, të qetë dhe të sigurt. Kur'ani është mëshirë që lehtëson trysninë që njerëzit e shkaktojnë mbi njëri tjetrin, largon rregullat e ashpra dhe parimet e panevojshme dhe kufizuese, lehtëson problemet e njerëzve dhe siguron një jetë të qetë.

Vërtet, Allahu shpall se duke komunikuar porosinë e Tij, i Dërguari ua lehtëson njerëzve barrat e tyre të rënda dhe ua heq zinxhirët rreth tyre. Veç kësaj, ata të cilët i përgjigjen thirrjes së të Dërguarit dhe pastaj e mbështesin, ndihmojnë dhe mbrojnë atë dhe ndjekin rrugën e vërtetë të Allahut do të arrijnë shpëtimin: paqen, lumturinë dhe mirësitë. Siç lexojmë:

**Ata që e pranojnë të Dërguarin (Muhammedin), Pejgamberin arab, (që nuk shkruan as nuk lexon), të cilin e gjejnë të cilësuar (të përshkruar me virtytet e tij), te ata në Tëvrat dhe në Inxhil, e që i urdhëron ata për çdo të mirë dhe i ndalon nga çdo e keqe, u lejon ushqimet e këndshme dhe u ndalon ato të pakëndshmet, dhe heq nga ata barrën e rëndë të tyre dhe prangat që ishin mbi ta. Pra, ata të cilët e besojnë atë, e nderojnë dhe e ndihmojnë atë dhe veprojnë me Dritën që u zbrit me të, të tillët janë të shpëtuarit. (Sure A'raf: 157)**

Në shoqëritë ku njerëzit nuk jetojnë sipas parimeve të Kur'anit, disa rregulla të ashpra pa nevojë i bëjnë jetërat e njerëzve të vështira dhe bëjnë që shumë probleme të mbeten të pazgjidhura. Parimet dhe botëkuptimi i ushqyer në mendjet e njerëzve vendosin rregulla dhe

ndalesa të reja dhe përmes këtyre kufizimeve, i nënshtrojnë njerëzit ndaj trysnisë së panevojshme. Për shembull, mund të ndalohet ndonjë ushqim i lejuar. Ose, sjellja e njerëzve mund të kufizohet për arsye se veprime të caktuara shpallen të palejueshme. Çdo shoqëri ka disa rregulla dhe praktika që burojnë prej vet kulturës dhe interesave të tyre. Edhe pse ato nuk shprehen gojarisht, ato praktikohen dhe zbatohen në përgjithësi, prej të gjithë pjesëtarëve të shoqërisë.

Në fund të fundit, njerëzit përpiqen të dëshmojnë tek të tjerët dhe paraqesin vetveten sikur ata të kishin cilësi superiore. Rrjedhimisht, nën rregullat dhe kufizimet shtypëse të shoqërisë, njerëzit nuk mund të flasin lirshëm, të qeshin apo të jetojnë siç kanë dëshirë, sepse jetojnë nën kërcënimin e vazhdueshëm shoqëror të poshtërimit, dënimit apo përgojimit.

Njerëzit të cilët nuk e njohin Allahun, që nuk e mbështesin besimin e tyre në Të dhe nuk i nënshtrohen Atij dhe që nuk jetojnë në pajtim me parimet e Kur'anit bëhen strehë e shqetësimeve të panumërta: e frikës për të ardhmën, të mbeturit vetëm, e plakjes, e pësimit të një aksidenti, e vdekjes, e përjetimit të rrezikimit të shëndetit të fëmijëve të tyre, humbjes së pasurisë, dështimit në biznes apo martesë, të qenit i privuar nga një shkollim i mirë dhe kështu me rradhë.

Të gjitha këto janë burim i ankthit aspak të palehtësuar. Padyshim, parimet morale të Kur'anit u mundësojnë njerëzve t'ju shmangen shqetësimeve të tilla, sepse njerëzit që janë të larguar prej vlerave të Islamit janë të pavetëdijshëm se çdo gjë ndodhë me Vullnetin e Allahut dhe se gjithçka është e paracaktuar. Ata nuk arrijnë të gëzojnë se ndodhitë e mira dhe të këqija në jetë janë sprova dhe se Allahu dhuron dhe është pronar i të gjitha mirësive dhe bukurive. Për

këtë arsye, shoqëritë e përbëra prej individëve të tillë karakterizohen me tendosje, kaos, shqetësim, ankth dhe pasiguri.

Një shoqëri e përbërë prej njerëzve të cilët zbatojnë parimet morale të Kur'anit është immune ndaj gjërave të tilla negative, gjë që mund të vërehet në përsosmërinë morale të pjesëtarëve të saj. Të tillët mbështesin besimin e tyre në Allahun dhe janë këmbëngulës dhe poashtu tregojnë mëshirë, dhembshuri dhe dashuri. Të përlulur dhe të kënaqur thellë në qenien e tyre, ata ndiejnë qetësi dhe ngushëllim që jetojnë në pajtim me fenë e përshkruar prej Allahut. Siç porositet Kur'an, ata nuk i frikësohen askujt pos Tij dhe punojnë për të fituar kënaqësinë e Tij mbi çdo gjë tjetër. Ata e dijnë se çdo mirësi që gëzojnë është prej Allahut dhe se humbja e çdo gjëje të shtrenjtë është sprovë prej Allahut dhe kështu ruajnë qetësinë e tyre kur arrijnë sukses apo kur ndeshen me ndonjë ndodhi të papritur. Ata poashtu nuk reagojnë pa menduar kur përballen me vështirësi apo probleme.

Kur'an qartë shpjegon atë që është e ligjshme dhe e paligjshme dhe shpjegon në hollësi parimet morale me të cilat Allahu është i kënaqur. Për këtë arsye, rregullat e vetma që udhëheqin jetën e besimtarëve janë ato që përmenden në Kur'an, sepse ai paraqet gjykimet që i përshtaten natyrës së njeriut duke siguruar një lehtësim të ndërgjegjës dhe duke sjellur qetësi dhe siguri. Allahu pohon se Ai ka për qëllim t'ua lehtësojë njerëzve barrat e rënda të tyre, si vijon:

**All-llahu dëshiron t'ju sqarojë çështjet e t'ju drejtojë në rrugën e atyre që ishin para jush (pejgamberët) dhe t'ju pranojë pendimin. All-llahu e di më së miri gjendjen e robërve dhe është më i Urti. All-llahu dëshiron t'ju pranojë pendimin, e ata që ndjekin dëshirat e epsheve, dëshirojnë që ju të shmangeni në tërësi (nga rruga e drejtë). All-llahu dëshiron t'ju lehtësoj**

**(dispozitat), e megjithatë njeriu është i paaftë (për të përballuar epshet). (Sure Nisa: 26-28)**

Bediuzzaman Said Nursi shpjegon parajsën shpirtërore që do ta gëzojnë ata, pikërisht në këtë jetë, të cilët jetojnë në pajtim me Kur'anin dhe urdhërat e tij:

*Në momentin që e pashë këtë botë në mes të errësirës, zemra, shpirti dhe mendja ime dhe të gjitha aftësitë e mia njerëzore, vërtet, të gjitha grimcat e qenies sime, ishin të gatshme të qajnë dhe të klithin nga dhimbja. Por papritur, Emri i Allahut të Plotëfuqishëm i të Drejtit u ngrit në simbolin e të Gjithëdijshmit, dhe Emri i Mëshirëplotit në simbolin e Bujarit të Madh, Emri i të Gjithëmëshirshmit në simbolin (domethënë, në kuptimin e) Atij që falë gjithnjë, Emri i Ringjallësit në simbolin e Trashëguesit, Emri i Dhuruesit të Jetës në simbolin e Zemërgjerit dhe Emri i Mbështetësit u ngrit në simbolin e Zotëruesit. Ato praruan dhe mbushën me dritë shumë botëra brenda botës së njerëzimit. Duke hapur dritaret e botës së ndritshme të jetës së përtejme, ato shpërndanë drita mbi botën e errët të njeriut. (Nursi, “Letrat: Letra e 29-të”)*

Allahu pajisi njerëzimin me një natyrë që kurrë nuk gjenë qetësi dhe prehje në një sistem jo-Islam. Duke nënvizuar dallimin në mes të besimtarëve dhe mosbesimtarëve, kjo cilësi e besimtarëve bëhet më e dukshme në Ahiret. Ata të cilët nuk jetojnë në pajtim me Kur'anin janë të dëshëruar, ndërsa besimtarët përjetojnë lumturi të madhe:

**E kur të vijë ajo Ditë (e Gjykimit), askush nuk do të flasë, pos me lejen e Tij, e prej tyre (të tubuarve), ka fatzi dhe fatbardhë. (Sure Hud: 105)**

# ALLAHU PARALAJMËRON NJERËZIMIN ME KUR'AN

*Ai (All-llahu) ia shpalli (Kur'anin) të saktë (pa shmangje), pët t'ua tërhequr vërejtjen (atyre që nuk besojnë) ndaj një dënimi të rëndë prej Tij, e për t'i përgëzuar besimtarët që bëjnë vepra të mira, se ata do të kenë një shpërblim të mrekullueshëm. (Sure Kehf: 2)*

**V**argjet që paralajmërojnë njerëzimin për vuajtjet e Ferrit janë njëra prej vetive më të rëndësishme të Kur'anit. Ata të cilët paralajmërohen kuptojnë plotësisht se si të bëjnë dallimin në mes të së drejtës dhe të gabuarës, të mirës dhe të keqes. Kjo veti rrëfehët si vijon:

**Ai (All-llahu) ia shpalli (Kur'anin) të saktë (pa shmangje), pët t'ua tërhequr vërejtjen (atyre që nuk besojnë) ndaj një dënimi të rëndë prej Tij, e për t'i përgëzuar besimtarët që bëjnë vepra të mira, se ata do të kenë një shpërblim të mrekullueshëm. (Sure Kehf: 2)**



**Ne e bëmë atë (Kur'anin) të lehtë me gjuhën tënde vetëm që me të t'i përgëzosh të devotshmit, dhe me të t'i tërheqësh vërejtjen një populli që është kryeneç. (Sure Merjem: 97)**

Siç sugjeron vargu në: **“Mua më është shpallur ky Kur'an që me të t'ju tërheqë vërejtjen juve dhe atij që i komunikohet (dhe të gjithë atyre që vijnë pas jush deri në ditën e kijametit)”** (Sure En'am: 19), Profeti ynë (saas) mori përgjegjësinë që të paralajmërojë çdokend që mund të arrinte. Në një varg tjetër, Allahu pohon se Ai ia shpalli Kur'anin Profetit tonë (saas) në mënyrë që ai të mund t'i paralajmëronte njerëzit:

**Prandaj, Ne të shpallëm ty Kur'an Arabisht që ta këshillosh kryefshatin (Mekën) dhe ata përreth saj, dhe t'u tërheqësh vërejtjen për Ditën e Tubimit (kijametit), për të cilën nuk ka dyshim. Një grup për në Xhennet, kurse një grup për në Zjarr. (Sure Shura: 7)**

Siç pohojnë këto vargje, Allahu përshkruan në Kur'an momentin e vdekjes, mënyrën se si engjujt do ta nxjerrin shpirtin e personit të ndjerë, mënyrën se si njerëzimi do të tubohet, mënyrën se si do të zhvillohet dhënia e llogarisë, ngjarjet në lidhje me Ditën e Gjykimit, mënyrën se si njerëzit do të dërgohen në Ferr të shoqëruar pas dhënies së llogarisë, për atë se çfarë do të përjetojë secili shpirt atë ditë, vuajtjet e përrjetshme në Ferr, vuajtjet shpirtërore dhe materiale dhe dhimbjen që banorët e tij do të vuajnë si edhe bukurinë dhe mirësitë e pashembullta të Parajsës dhe paralajmëron njerëzit për Ditën e Gjykimit.

Me të vërtetë, shumë vargje përshkruajnë mënyrën se si njerëzit në Ferr bisedojnë me njëri tjetrin, jetën e tyre shoqërore dhe mënyrën se si

do të vazhdojnë të fjalosen përkundër gjithë vuajtjes së tyre. Disa vargje madje përmendin argumentet e tyre, si vijon:

**Dhe ti tërhiqju vërejtjen njerëzve për ditën kur atyre do t'u vijë dënimi, e ata që ishin mizorë thonë: “Zoti ynë, na jep afat për një kohë të shkurtër t'i përgjigjemi thirrjes tënde (për besim) dhe t'i pasojmë të Dërguarit!” Do t'u thuhet: “A nuk u betuat ju më parë se për ju nuk ka lëkundje (prej dynjasë në botën tjetër)?” (Sure Ibrahim: 44)**

**Ai (All-llahu) thot: “Mos u grindni tash para Meje, se Unë më parë ju tërhoqa vërejtjen. Tek Unë nuk ndryshon fjala (vendimi) dhe Unë nuk jam zullumqar për robërit”. (Përkujto) Ditën kur Ne Xhehennemit i themi: “A je mbushur?” E, ai thot: “A ka ende?” (Sure Kaf: 28-30)**

**Dhe ata që nuk besuan thanë: “Ne nuk i besojmë këtij Kur'ani, e as atij që ishte para tij, (librave të tjerë).” E sikur t'i shihje zullumqarët kur të dalin para Zotit të tyre të ndalen, kthejnë fjalën (fyese) njëri-tjerit, atyre që ishin pari, u thonë: “Sikur të mos ishit ju, ne do të kishim qenë besimtarë!” (Sure Sebe': 31)**

Posa të gllabërohen nga vuajtjet, nuk do të ketë shpëtim për ata që ua kthyen shpinën paralajmërimeve të Kur'anit. Ata do të pendohen kur do të shohin Engjujt e Vdekjes duke ardhur për ta. Mirëpo, një pendim i tillë i madh nuk do t'u sjell dobi atyre, sepse këta njerëz zgjodhën rrugën e mosbesimit kur të Dërguarit e komunikuan porosinë e Allahut. Një varg lexon:

**Dhe ata do të klithin aty: “O Zoti ynë, nxjerrna e të bëjmë vepra të mira, e jo si ato që i bënim!” Po a nuk u dhamë juve jetë aq sa që ai që ka dashur të mendojë, ka mundur të mendojë gjatë asaj kohe,**

**madje juve u ka ardhur edhe Pejgamberi (Paralajmëruesi), prashijoni, se për zullumqarët nuk ka ndonjë ndihmëtar. (Sure Fatir: 37)**

Besimtarët të cilët kalojnë çdo moment të jetës së tyre për të fituar kënaqësinë dhe mëshirën e Allahut, dhe të cilët jetojnë në pajtim me ndërjegjet e tyre, shpërblehen me Parajsë në Jetën e Përtejme. Kur'ani rrëfen se Engjujt e Vdekjes do t'i marrin shpirtërat e njerëzve të tillë të virtytshëm në Parajsë në grupe në mënyrën e dhënë në vazhdim:

**Është Xhenneti i Adn-it, ku do të hyjnë, nën të rrjedhin lumenj, aty kanë çka të dëshirojnë, ashtu i shpërblen All-llahu të ruajturit. Të cilët duke qenë të pastër, engjëjt ua marrin shpirtin, duke u thënë: “Esselamu alejkum (Paqja qoftë mbi ju!)” Hyni në Xhennet, për hir të asaj që vepruat. (Sure Nahl: 31-32)**

Kur'ani poashtu përcjellë fjalët e besimtarëve, të cilëve u jepet një pozitë e nderuar dhe e lartë në Parajsë. Ata gjithmonë lartësojnë/lavdërojnë Allahun në bisedat e tyre, të cilat janë gjithmonë të bazuara në temat e bukurisë, dashurisë, paqes dhe mirësisë:

**E ata thonë: “Falënderuar qoftë All-llahu që largoi prej nesh brengat; vërtet, Zoti ynë është që falë shumë dhe është Bamirës. i Cili nga mirësia e Tij na vendosi në vendin e përjetshëm, ku nuk do të na prekë ndonjë mundim fizik dhe ku nuk na prek ndonjë molisje. (Sure Fatir: 34-35)**

**E ata (të Xhennetit) thanë: “Falënderuar qoftë All-llahu, i cili premtimin e Vet e bëri realitet ndaj nesh dhe na la në disponim tokën e Xhennetit që të vendosemi aty ku të duam! Sa shpërblim i mirë është i atyre që vepruan drejtë”. (Sure Zumer: 74)**

**(Këta) Thonë: “Ne edhe kur ishim në familjet tona, ishim ata që**

**frikësoheshim. E All-llahu na dhuroi të mira dhe na ruajtí prej dënimit të erës (flakës) së nxehtë të zjarrit. Ne më parë ishim ndër ata që lutëm Atë, e Ai është Bamirës, Mëshirues". (Sure Tur: 26-28)**

Siç bëhet e qartë në këto vargje, besimtarët janë të vetëdijshëm se mund të arrijnë këtë fund të lumtur vetëm me Vullnetin dhe Mëshirën e Allahut. Duke marrë parasysh të kuptuarit e tyre se vetëm Mëshira dhe mbrojtja e Allahut mund t'i udhëzojë ata në rrugën e drejtë, besimtarët gjithmonë falënderojnë Allahun në Parajsë, pikërisht sikurse e falënderojnë në këtë jetë.

# MUSLIMANËT JETOJNË PLOTËSISHT SIPAS VLERAVE TË KUR'ANIT

*Ky (Kur'ani) është sqarim për njerëzit, është  
udhëzim dhe këshillë për të devotshmit.  
(Sure Ali Imran: 138)*

**K**riteri i vetëm mbi të cilin mbështeten jetërat e Muslimanëve është Kur'ani dhe Sunneti i Profetit tonë (saas). Derisa të vdesin, ata në përpikmëri u binden urdhërave të Allahut, i frikësohen vetëm Allahut, kërkojnë ndihmë vetëm prej Tij dhe kurrë nuk ndiejnë frikë, panikë apo dëshpërim. Ata nuk i frikësohen fajësimit të cilitdo njeri. Kur ndeshen me ndodhi të papritura, ata gjithmonë sillen në pajtim me Kur'anin dhe Sunnetin e Profetit tonë (saas). Ata shfaqin të njëjtën përsosmëri morale në kohëra të vështirësisë dhe telasheve, pikërisht sikurse veprojnë kur t'u jenë dhuruar mirësi dhe begati, sepse ata janë të vetëdijshëm se vetëm Allahu dhuron më shumë mirësi apo ju kufizon ato atyre për një qëllim hyjnor dhe se Allahu dërgon vështirësi për t'i bërë njerëzit më të pjekur.

Mirëpo, ata që nuk e përfillin Kur'anin dhe dështojnë në përqaftimin e Islamit mbështesin tërë jetërat e tyre në fitimin e miratimit të njerëzve. Filozofia e tyre e jetës, parimet dhe pikëpamjet bien në kundërshtim me Kur'anin. Duke mos qenë në gjendje të pasojnë Kur'anin dhe Sunnetin e Profetit tonë (saas) si udhërrëfyes, ata formulojnë rituale, zakone dhe forma të adhurimit që nuk janë në pajtim me parimet morale Islamike.

Siç u tha njerëzve të tij Profeti Shuajb (as), në vend se të zbatojnë urdhërat e Allahut, të tillët pasojnë të gjitha format e besimeve dhe rregullave të padrejta, sikur ato të ishin gjykime hyjnore: **“O populli im, a është më i çmuar te ju farefisi im se All-llahu, që me përbuzje e keni hedhur pas shpine? (Sure Hud: 92).** Madje edhe nëse e shohin të vërtetën në Kur'an, nuk mund t'i braktisin besimet e tyre të padrejta. Të kuptuarit e tyre të asaj që është e ligjshme dhe e paligjshme ndryshon në pajtim me arsyen dhe mendimet e tyre të shtrembëruara, gjykimet e vlerave të shoqërisë së tyre dhe ajo që ata trashëgojnë prej paraardhësve të tyre. Ata respektojnë mendimet e njerëzve më shumë se gjykimet e Kur'anit.

Botëkuptimi i njerëzve të tillë theksohet në Kur'an si vijon: **“Ne i gjetëm të parët tanë në këtë fé dhe ne jemi të orientuar gjurmëve të tyre”.** (Sure Zukhruf: 23).

Kur'ani, Fjala e pandryshueshme e Allahut, transmeton rrugën e vetme drejtë shpëtimit si në këtë botë ashtu edhe në atë të ardhmën. Ndërsa, përsosmëria morale e shfaqur nga Profeti ynë (saas) është shembull për besimtarët.

# UDHËRRËFYESI I VETËM I PROFETIT TONË (SAAS) ISHTE KUR'ANI

*Ti (Muhammed) praktiko atë që t'u shpall nga  
Zoti yt. S'ka Zot, përveç Tij.  
Largohu prej idhujtarëve.  
(Sure En'am: 106)*

Allahu zgjodhi Profetin tonë (saas) dhe i shpalli atij Kur'anin, i cili do të zbatohet deri në Ditën e Gjykimit. Kur'ani poashtu na informon se Profeti Muhammed (saas) është Profeti i fundit. Profeti ynë (saas) pasoi Kur'anin dhe këshilloi njerëzit që ta lexojnë atë dhe t'i respektojnë vetëm gjykimet e tij. Vargjet në lidhje me këtë japen në vazhdim:

**Ti (Muhammed) praktiko atë që t'u shpall nga Zoti yt. S'ka Zot, përveç Tij. Largohu prej idhujtarëve. (Sure En'am: 50)**

**Ti ec pas asaj që të shpallet dhe bëhu i durueshëm derisa All-llahu të gjykojë. Ai është më i miri i gjykatësve! (Sure Junus: 109)**

Profeti ynë (saas) poashtu u rekomandoi shoqëruesve të tij që të lexojnë Kur'anin dhe t'i zbatojnë urdhërat e tij:

*Pse disa njerëz imponojnë kushte që nuk janë të pranishme në Librin e Allahut (Ligjet)?*

*Kushdo që e imponon një kusht që nuk është prej Ligjeve të Allahut, atëherë ai kusht është i pavlerë edhe nëse ai imponon njëqind kushte, sepse kushtet e Allahut janë më detyruese dhe më të besueshme. (Bukhariu)*

*Libri i Allahut është litari i Allahut; ai i cili e pason atë është i udhëzuar dhe ai i cili e braktis atë është në gabim. (Muslimi)*

*Ai i cili foli në pajtim me Kur'anin foli të vërtetën dhe ai i cili vepron në pajtim me udhëzimet e tij i jap të drejtë vetes për shpërblim. Përsëri, ai i cili gjykon në pajtim me Kur'anin është i drejtë dhe i qartë. Pastaj, sa për atë i cili i fton njerëzit në Kur'an është vërtet i udhëzuar në Rrugën e Drejtë. (Tirmidhiu)*

Ndërsa urdhëronte të mirën dhe ndalonte të keqen, Profeti ynë (saas) ndjekte vetëm Kur'anin si udhëzues. Të gjitha fjalët e tij buronin prej tij: **“Unë (nuk trilloj) i përmbahem vetëm asaj që më shpallet nga Zoti im. Ky (Kur’ani) është argument i qartë (me të cilin ndriçohen zemrat) nga Zoti juaj, është udhërrëfyes dhe mëshirë për popullin që beson.** (Sure A’raf: 203). Për shembull, populli i tij e pyeti atë për fetva (mendim ligjor në lidhje me ligjin Islamik) për femrat. Allahu i tha të Dërguarit të Tij (saas) të thot: **“All-llahu ju sqaron nga libri (Kur’ani) përkitazi me gratë jetime”** (Sure Nisa’: 127). Ngjashëm, kur njerëzit pyetën për fetva për trashëgimi, Allahu e urdhëroi atë të thot: **“Allahu ju jap**



**fetva/përgjigje për njerëzit të cilët vdesin pa trashëgimtar të drejtpërdrejt” dhe “All-llahu ju sqaron, ashtu që të mos humbni. All-llahu di për çdo send. (Sure Nisa’: 176)**

Në një varg tjetër, Allahu i shpall Profetit tonë (saas) që t’u përgjigjet si në vazhdim atyre të cilët thonë:

**“Sillna një Kur’an tjetër, ose ndryshoje këtë!”**

**Thuaj: “Mua nuk më takon që ta ndryshojë vet, unë përcjelli vetëm atë që më shpallet. Nëse e kundërshtoj Zotin tim i frikësohem dënimit të një Dite të Madhe. (Sure Junus: 15)**

Rrjedhimisht, Sunneti i Profetit tonë (saas) është të zbatohet Kur’ani në jetën e përditshme. Për këtë arsye, Allahu na bën me dije se bindja ndaj tij është një parim themelor i besimit. Në një varg, Allahu pohon se bindja e tillë është në të vërtetë bindje ndaj Tij (Sure Nisa’: 80).

Cilido që i bindet fjalëve të tij dhe pason Sunnetin e tij zbaton poashtu gjykimet e Kur’anit, sepse çdo qëndrim, vendim dhe fjalë e Profetit tonë (saas) buron prej Kur’anit. Në traditën profetike të dhënë në vazhdim, Profeti ynë (saas) tha:

*Ai i cili më bindet mua i është bindur Allahut dhe ai i cili nuk më bindet mua nuk i është bindur Allahut; ai i cili i bindet Emirit (Sundesit që unë e emëroj) më është bindur mua dhe ai i cili nuk i bindet Emirit nuk më është bindur mua. (Bukhariu)*

Siç pohon Kur’ani, Profeti ynë (saas) ishte një person me përsosmëri morale i cili pikëllohej nga vuajtja e besimtarëve. Ai ishte thellësisht i brengosur për besimtarët dhe ishte i butë dhe i mëshirshëm ndaj tyre (Sure Teube: 128); një person fisnik i cili

urdhëronte të mirën dhe ndalonte të gabuarën dhe i cili ua lehtësoi besimtarëve barrat e rënda të tyre dhe ua hoqi zinxhirët rreth tyre (prangat që ishin mbi ta) (Sure A'raf: 157); dhe ishte bekim për njerëzit, i pastroj ata dhe ua mësoi atyre Librin dhe Urtësinë (Kur'anin dhe Sheriatin) (Sure Ali Imran: 164).

Për të qenë Musliman i vërtetë me të cilin Allahu është i kënaqur, njeriu duhet t'i bindet urdhërave të Kur'anit, të përqafojë Sunnetin e Profetit tonë (saas) dhe të praktikojë në përpikmëri çfarëdo që ato na thonë të bëjmë. Pasiqë Kur'ani jap shpjegim të hollësishëm për jetën e Profetit tonë (saas), Muslimanët janë të detyruar ta studiojnë jetën e tij, të shkojnë hapave të tij dhe të përpiqen të shfaqin përsosmërinë e tij morale. Në Kur'an, Allahu shpjegon se Profeti (saas) jap shembullin më të mirë për besimtarët:

**Ju e kishit shembullin më të lartë në të dërguarin e All-llahut, kuptohet, ai që shpreson në shpërblimin e All-llahut në botën jetër, ai që atë shpresë e shoqëron duke e përmendur shumë shpesh All-llahun. (Sure Ahzab: 21)**

# EDUKIMI I NJË BREZI SHEMBULL QË PASON KUR'ANIN

*Nga ju le të jetë grup që thërret në atë që është e  
dobishme, urdhëron për punë të mbara dhe  
ndalon nga e keqja. Të tillët janë ata të  
shpëtuarit. (Sure Ali Imran: 104)*

**S**humë njerëz marrin njerëz të tjerë si shembuj dhe përpiqen të jenë sikur ata. Që nga kultura e tyre deri te mënyra se si flasin apo vishen, ata imitojnë këta njerëz dhe ju pikon zemra për mënyrën e jetesës së tyre. Por gadi të gjithë këta shembuj kanë dështimet e tyre dhe posedojnë parime morale ose kuptim që shpiejnë njerëzit drejt të keqes. Për njerëzimin, shembulli më i mirë për ta ndjekur është ai i Profetit tonë (saas), sepse zanafilla e parimeve të tij morale dhe e përsosmërisë së tij morale është Kur'an. Profeti ynë (saas) dhe shokët e tij ishin të ndërgjegjshëm, njerëz që kishin frikën e Allahut dhe ishin mishëruar me parimet morale të Kur'anit dhe ndienin dashuri të thellë për Allahun.

Allahu nderoi besimtarët me vetinë e **“sunduesve (zëvendësuesve) në Tokë”** (Sure En'am: 165), dhe ju dha nder si në këtë botë ashtu edhe në atë të ardhmën. Historia ishte dëshmitare e formave më të përsosura të paqes, lumturisë, sigurisë, drejtësisë, dashurisë, miqësisë, vëllazërisë dhe motërsisë, dhembshurisë dhe sakrificës në tokat e sunduara nga Profeti ynë (saas). Vërtet, kjo periudhë u quajt **“Periudha e Lumturisë.”** Allahu dha lajmin e mirë të këtij shpërblimi, të cilin besimtarët e sinqertë do ta marrin derisa janë ende duke jetuar në këtë botë:

**Kush bën vepër të mirë, qoftë mashkull ose femër, e duke qenë besimtar, Ne do t'i japim atij një jetë të mirë (në këtë botë), e (në botën tjetër) do t'u japim shpërblimin më të mirë për veprat e tyre. (Sure Nahl: 97)**

Për këtë arsye, është e një rëndësie të madhe që ky brez i tanishëm të edukojë një brez të ri të përbërë prej njerëzve të cilët mendojnë, sundojnë, flasin dhe vendosin në pajtim me Kur'anin dhe Sunnetin e Profetit tonë (saas). Kur'ani jap një shpjegim të hollësishëm të vetive të një shoqërie të tillë Muslimane, shoqëri në të cilën besimtarët e sinqertë ndjekin hapat e të Dërguarit (saas) dhe përpiqen të fitojnë vetëm kënaqësinë e Allahut. Disa prej vetive të tyre janë si vijon:

- Ata e adhurojnë vetëm Allahun. (Sure Fatiha: 3)
- Ata i janë nënshtruar Allahut. (Sure Teube: 51)
- Ata janë të vetëdijshëm se janë të dobët/të pafuqishëm në Praninë e Allahut. (Sure Xhinn: 22)
- Ata i frikësohen Allahut dhe me devotshmëri i shmangen çfarëdo forme të moralit që nuk i pëlqen Atij. (Sure Ra'd: 21)

- Ata janë mirënjohës ndaj Allahut nën çfarëdo rrethana. (Sure Bekare: 172)

- Ata janë që falin dhe janë tolerant. (Sure Hixhr: 85)

- Ata janë që ecin nëpër tokë të qetë. (Sure Furkan: 63)

- Ata janë të ndijshëm dhe të mëshirshëm. (Sure Teube: 128)

- Ata urdhërojnë për punë të mbara dhe ndalojnë nga e keqja. (Sure Ali Imran: 104)

- Ata janë të bashkuar dhe solidar. (Sure Saff: 4)

- Ata mbrojnë gjithmonë ndershmërinë dhe drejtësinë dhe nuk i përkrahin kurrë keqbërësit. (Sure Nisa': 58, 105)

- Ata janë që mbajnë premtimet e tyre. (Sure Bekare: 177)

- Ata i shmangen të folurit kufër (mosbesues). (Sure Furkan: 72)

- Ata janë të durueshëm dhe dhe për atë që i godet në rrugën e Allahut, ata as nuk dobësohen dhe as nuk përuhen. (Sure Hud: 55)

- Ata janë të besueshëm dhe të guximshëm. (Sure Junus: 71)

- Ata veprojnë në përputhje me parimet e Islamit. (Sure A'raf: 89)

- Ata nuk i shtyjnë me forcë njerëzit që t'i pranojnë idetë e tyre; ata vetëm i shpjegojnë ato. (Sure Nahl: 125)

- Ata nuk kërkojnë ndonjë shpërblim për përpjekjet e tyre. (Sure Shura: 23)

- Ata nuk i shmangen thënies të së vërtetës. (Sure Maide: 54)

- Ata gjejnë kënaqësi në art dhe estetikë.

- Ata janë kundër fanatizmit dhe jotolerancës.

Kur këto cilësi të bëhen dominante, shtrembërimi moral, luftërat, varzhdësia, varfëria, mashtrimi, fatkeqësitë shoqërore, problemet dhe vështirësitë që mbisundojnë aktualisht në mbarë botën do të zëvendësohen me paqe, siguri, drejtësi, tolerancë, miqësi dhe

bamirësi, sepse parimet morale të Kur'anit i sjellin pasuri dhe bukuri shpirtërore dhe materiale njerëzimit. Në përgjithësi, të jetuarit në pajtim me Kur'anin do të krijojë zgjidhje të përhershme për të gjitha problemet.

Me vargun: **“O ju që besuat, hyni në Islam tërësisht (Përqafoni fenë Islame në tërësi), e mos ndiqni rrugën e djallit, sepse ai është armik i juaj i hapët.** (Sure Bekare: 208), Allahu thërret njerëzit të jetojnë sipas vlerave të Kur'anit.

Ata të cilët i refuzojnë traditat dhe zakonet e padrejta të shoqërisë së tyre dhe ndjekin Kur'anin janë, në terminologjinë e Kur'anit, ata të cilët “hynë në Islam.” Përndryshe, krijohen shoqëritë fanatike, të pasinqerta, të frikshme, të druajtura, mendjengushta, të paditura, të paurta dhe të pamatura që strehojnë besime të panumërta të padrejta. Pjesëtarët e tyre jetojnë vetëm për t'i kënaqur trillet dhe dëshirat e tyre, ndjekin qëllime tokësore, nuk njohin kufinjë në imoralitet dhe ndihen të pushtuar nga trysnia e rregullave dhe parimeve që burojnë prej sistemeve të paditura. Natyrisht se njeriu nuk do mund të shpresojë të jetojë një jetë tolerante, të qytetëruar, të qetë dhe të sigurt në një shoqëri të tillë.

Për këtë arsye, çdo njeri që beson duhet të jetë mirënjohës ndaj Allahut, sepse Ai dhuroi besim të sinqertë për të gjithë besimtarët, i udhëzoi ata drejt të vërtetës dhe i nderoi ata me njohjen e Profetit tonë (saas). Mënyra për të treguar këtë mirënjohje është të shfaqen plotësisht parimet morale të Kur'anit dhe të pasohet Sunneti i Profetit tonë (saas). Refuzimi i kësaj është mosmirënjohje ndaj Allahut, një qëndrim që do të ndëshkohet rëndë në Ahiret.

# PËRFUNDIM

**K**ur njerëzit pyesin për fenë e tyre, shumica e njerëzve thonë se ata janë Muslimanë. Mirëpo, shumica prej tyre nuk e kanë lexuar Kur'anin, Librin e drejtë të Islamit, madje edhe vetëm një herë. Megjithatë, siç është përmendur gjatë këtij libri, Kur'ani është shpallja e Allahut nëpërmjet së cilës Ai paraqet Vetën dhe shpjegon qëllimin e vërtetë të jetës sonë në këtë botë dhe në botën tjetër, si edhe veçoritë e përsosmërisë morale.

Të jetuarit e jetës i pavatëdijshëm për pritjet e Allahut dhe të qenit i kënaqur me fe të sajua nuk i shkon për shtati ndërgjegjes dhe diturisë së një personi. Allahu pohon se Ai zbriti Kur'anin që njerëzit ta lexojnë:

**Ne me urtësi e zbritëm atë (Kur'anin) dhe me urtësi është zbritur. E ty nuk të dërguam tjetër vetëm se përgëzues dhe qortues. Dhe (ta shpallëm) Kur'anin që Ne e ndamë pjesë - pjesë për t'ua lexuar njerëzve dalëngadalë dhe ashtu e shpallëm atë një pas një. (Sure Isra: 105-106)**

Kur'ani është unik dhe prandaj shumë më superior se çdo libër tjetër. Për këtë arsye, informacioni që përmban ai është shumë më superior se çdo informacion tjetër. Çdo person i cili e lexon atë me qëllim të sigurtë dhe sheh mrekullitë, urtësinë unike dhe superioritetin që vargjet e tij përcjellin do të udhëzohet në të vërtetën. Pa marrë parasysh se a besojnë njerëzit në të apo jo, Kur'ani është përkujtues për të gjitha botërat dhe një mrekulli e Zotit tonë, siç lexojmë në:

**Thuaj: “I besuat ju atij ose nuk i besuat (atij nuk i bëhet dëm), e atyre që u është dhënë dijëni (nga librat e parë) para tij, kur u lexohet atyre, ata hudhen me fytyra (përdhe) duke i bërë sexhde”, dhe thonë: “I lartësuar është Zoti ynë, premtimi i Zotit tonë është i realizuar”. Dhe duke qarë hudhen me fytyra (kur dëgjojnë Kur'anin) dhe ai ua shton edhe më përuljen (ndaj All-llahut) (Sure Isra: 107-109)**

Njeriu kurrë nuk është tepër i vjetër për ta lexuar Kur'anin, për ta kuptuar atë dhe për t'i zbatuar urdhërat e tij në jetën e tij apo të saj. Duke qenë kështu, njeriu nuk duhet të pushtohet nga nxitjet që i pëshpëritë Shejtani, si: “Nuk e ke bërë këtë deri më sot, prandaj a do të kesh ndonjë dobi nëse e bën këtë tani e tutje?” dhe të jeni të kujdesshëm ndaj këshillave të ngjashme të shejtanit. Allahu do t'i mbajë njerëzit përgjegjës për gjendjen e tyre më të vonshme. Nëse një person, duke e parë të vërtetën, kthehet nga Allahu dhe Kur'ani dhe fillon të jetojë një jetë duke kërkuar kënaqësinë e Tij, Mëshirën dhe Parajsën, Allahu do ta pranojë pendimin e tij apo të saj.

Në këtë mënyrë, ata të cilët e dinë se do të vdesin një ditë dhe do të jetojnë një jetë të amshueshme dhe të cilët janë të vetëdijshëm për



Parajsën dhe Ferrin, duhet ta kenë parasysh gjendjen e tyre me ndërgjegje dhe urtësi dhe pastaj të vendosin se si të sillen. Ajo që i shkon për shtati ndërgjegjes dhe urtësisë së njeriut është që ta jetoj jetën duke kërkuar kënaqësinë e Allahut, Mëshirën e Tij dhe Parajsën dhe t'u bindet urdhërave të Tij. Siç pohon Ai në Kur'an:

**Lexo çka të është shpallur ty nga Libri i Zotit tënd! Nuk ka kush që mund t'i ndryshojë fjalët e Tij dhe pos Tij, nuk mund të gjesh stehim. (Sure Kehf: 27)**

# MASHTRIMI I EVOLUCIONIT

**D**arvinizmi, me fjalë të tjera teoria e evolucionit, u prezantua me qëllim të mohimit të faktit të krijimit, por që në të vërtetë nuk është asgjë përveç një marrëzi e dështuar joshkencore. Kjo teori, e cila pretendon se jeta lindi rastësisht nga materia e pajetë, u zhvlerësua nga faktet shkencore të “projektimit” të qartë në gjithësi dhe në gjërat e gjalla. Në këtë mënyrë, shkenca vërtetoi se Allahu krijoi gjithësinë dhe gjallesat në të. Propaganda e zhvilluar sot për të mbajtur në jetë teorinë e evolucionit mbështetet kryekëput në shtrembërimin e fakteve shkencore, interpretimin e paragjykuar dhe gënjeshttrat dhe pavërtetësitë e maskuara si shkencë.

Mirëpo kjo propagandë nuk mund ta fsheh të vërtetën. Fakti se teoria e evolucionit është mashtrimi më i madh në historinë e shkencës ka ardhur në shprehje shumë e më shumë në botën shkencore gjatë 20-30 viteve të fundit. Hulumtimet e bëra pas viteve të 80-ta në veçanti kanë zbuluar se pohimet e Darvinizmit janë krejtësisht të pabaza, gjë që është thënë nga një numër i madh i shkencëtarëve. Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës në veçanti, shumë shkencëtarë prej fushave të ndryshme biologjia, biokimia dhe paleontologjia pranojnë gjyminë e Darvinizmit dhe e përdorin

konceptin e projektimit inteligjent për të shpjeguar zanafillën e jetës. Ky “projektim inteligjent” është një shprehje shkencore e faktit se Allahu i krijoi të gjitha gjallesat.

Ne kemi ekzaminuar rënien e teorisë së evolucionit dhe provat e krijimit në mënyrë shumë të hollësishme shkencore në shumë prej punimeve tona dhe vazhdojmë ta bëjmë këtë. Duke pasur parasysh rëndësinë e madhe të kësaj çështjeje, do të jetë shumë e dobishme që ta bëjmë një përmbledhje të saj këtu.

## **Dështimi shkencor i Darwinizmit**

Teoria e evolucionit, edhe pse është një doktrinë që i ka fillimet në Greqinë e lashtë, u përqaftua gjerësisht në shekullin e nëntëmbëdhjetë. Zhvillimi më i rëndësishëm që e bëri teorinë temën kryesore të botës së shkencës ishte botimi në vitin 1859 i librit Origjina e Llojeve të Çarlls Darvinit. Në këtë libër, ai doli me pretendimin se llojet e ndryshme në tokë nuk janë krijuar veç e veç, por rrjedhin nga një stërgjysh i përbashkët dhe kanë ndryshuar nga njëra-tjetra nëpërmjet ndryshimeve të vogla me kalimin e kohës. Teoria e Darvinit nuk mbështetet në asnjë zbulim shkencor konkret, siç e pranoi edhe ai vet, ajo ishte vetëm një “supozim”. Veç kësaj, ashtu siç e pranoi Darvini në kapitullin e gjatë të librit të tij të titulluar “Vështirësitë e Teorisë”, teoria dështoi përballë një sërë çështjesh vendimtare.

Darvini mbështeti të gjitha shpresat e tij në zbulimet e reja shkencore, të cilat shpresonte që do të zgjidhnin këto vështirësi. Mirëpo, në kundërshtim me atë që ai shpresonte, zbulimet shkencore zgjeruan përmasat e këtyre vështirësive. Disfata e

darwinizmit përballë shkencës mund të përmbliidhet në tre tituj kryesorë:

1) Teoria nuk arrin të shpjegoj se si ka zënë fill jeta në tokë.

2) Nuk gjendet asnjë zbulim shkencor që tregon se “mekanizmat e evolucionit” të propozuara nga kjo teori, posedojnë asnjë force evoluese.

3) Të dhënat fosile provojnë pikërisht të kundërtën e ideve të parashtruara nga kjo teori.

Në këtë pjesë, do të shtjellojmë në vija të përgjithshme këto tri çështje themelore:

## **Pengesa e parë e pakapërcyeshme:**

### **Zanafilla e jetës**

Teoria e evolucionit pretendon se të gjitha speciet rrjedhin nga një qelizë e vetme e shfaqur në Tokën primitive 3.8 miliardë vjet më parë. Si është e mundur që një qelizë e vetme të ndërtojë miliona specie të gjalla e të komplikuar dhe, nëse me të vërtetë ka ndodhur diçka e tillë, përse nuk gjendet asnjë gjurmë në të dhënat fosile janë disa nga pyetjet në të cilat teoria nuk është në gjendje të jap përgjigje. Por në fillim, duhet të pyetemi: Si u krijua kjo “qelizë e parë”?

Meqë teoria e evolucionit e mohon krijimin dhe çfarëdo ndërhyrje të mbinatyrshe, ajo supozon se “qeliza e parë” është shfaqur rastësisht pa asnjë projektim, planifikim apo rregullim, përbrenda ligjeve të natyrës. Sipas kësaj teorie, materia e pajetë duhet të ketë krijuar rastësisht qelizën e gjallë. Por kjo hipotezë bie ndesh me ligjet më të pakundërshtueshme të biologjisë.

## “Jeta rrjedh nga jeta”

Darvini, në librin e tij, nuk ka folur kurrë mbi zanafillën e jetës. Koncepti primitiv shkencor në periudhën kur jetoi ai supozonte se gjallesat zotërojnë një konstrukt shumë të thjeshtë. Sipas teorisë së krijimit të rastësishme që besohet në mesjetë, lëndët e pajetë/inorganike, duke u bashkuar, mund të formojnë një qenie të gjallë. Në atë periudhë ishte shumë i përhapur mendimi se insektet formoheshin nga tepricat e ushqimeve, ndërsa minjtë nga gruri. Për të provuar diçka të tillë janë bërë eksperimente nga më të çuditshmet: Një leckë e ndotur me pak grurë mbi të, në një anë, ndërsa në anën tjetër një shkencëtar, duke pritur që pas një kohe të formoheshin minj.

Gjithashtu mendohej se shfaqja e krimbave në një copë mishi ishte dëshmi e krijimit të vetvetishëm/spontan. Por më vonë do të kuptohej se ata krimba nuk formoheshin vetvetiu në mish, por nga larvat e padukshme për syrin që silleshin nga mizat.

Madje edhe kur Darvini shkroi librin Origjina e Llojeve, besimi se bakteret formoheshin nga materia e pajetë ishte një gjë e pranuar gjerësisht në botën e shkencës.

*Por vetëm 5 vite pas botimit të librit të Darvinit, Lui Paster shpalli përfundimet e arritura pas shumë studimeve dhe eksperimenteve të gjata që rrëzuan plotësisht krijimin spontan, i cili përbënte gur-themel in e teorisë së Darvinit. Në ligjëratën e tij triumfale në Sorbonë në vitin 1864, Pasteri tha: “Kurrë më nuk do të rimarr veten krijimi spontan prej grushtit vdekjeprurës të dhënë nga ky eksperiment i thjeshtë.”<sup>1</sup>*

Mbrojtësit e teorisë së evolucionit i kundërshtuan për një kohë të gjatë zbulimet e Pasterit. Mirëpo shkenca, e cila po përparonte duke nxjerrë në dritë ndërtimin kompleks të qelizës së organizmit të gjallë, e përforcoi edhe më tepër pavlefshmërinë e pretendimeve mbi krijimin e rastësishëm të jetës.

### **Përpjekjet e pafrytshme të shekullit njëzet**

Evolucionisti i parë, i cili u mor me çështjen e zanafillës së jetës në shekullin e njëzet ishte biologu i njohur rus Aleksandër Oparin, i cili u mundua të provonte, me anë të një sërë tezash të hedhura nga vetë ai në vitet 1930, se qeliza e gjallë mund të krijohej rastësisht. Por këto punime do të dilnin të pasuksesshme dhe Oparin do të detyrohej ta bënte këtë rrëfim:

*Mirëpo, fatkeqësisht, çështja e zanafillës së qelizës përbën ndoshta pikën më të errët të gjithë studimit të evolucionit të organizmave.<sup>2</sup>*

Pasuesit evolucionist të Oparinit u munduan të bënin eksperimente për të gjetur një zgjidhje për këtë çështje. Më i njohuri nga këto eksperimente ishte ai që u ndërmor në vitin 1953 nga kimisti amerikan Stenli Miler, i cili, duke bashkuar gazrat, që ai pretendonte se kishin ekzistuar në atmosferën primitive në një ambient eksperimental dhe duke i ekspozuar ato ndaj një burimi të jashtëm energjie, Milleri formoi disa molekula organike (aminoacide) të pranishme në strukturën e proteinave.

Mezi kishin kaluar disa vite para se të zbulohej se ky eksperiment, i cili atëherë u paraqit si një hap i rëndësishëm në

emër të evolucionit, ishte i pavlefshëm, sepse atmosfera e përdorur në këtë eksperiment ishte shumë më e ndryshme nga kushtet reale të Tokës.<sup>3</sup>

Pas një periudhe të gjatë heshtjeje, Milleri pranoi se atmosfera e përdorur nga ai nuk ishte reale.<sup>4</sup>

Të gjitha përpjekjet evolucioniste që u ndërmorën gjatë shekullit të njëzet për të shpjeguar zanafillën e jetës përfunduan pa sukses. Xhefri Bada, gjeo-kimisti i njohur nga Instituti Skrips i San Diegos, në një artikull të botuar në vitin 1998 në revistën “*Earth (Toka)*”, pranon këtë fakt:

*Sot, duke e lënë pas shekullin e njëzet, akoma përballemi me problemin më të madh të pazgjidhur që kishim kur hymë në shekullin e njëzet: Si zuri fill jeta në tokë?<sup>5</sup>*

## **Ndërtimi i ndërlikuar i jetës**

Shkaku kryesor që çështja mbi zanafillën e jetës ka hyrë në një dilemë të tillë është se madje ata organizma të gjallë që mendohej të jenë më të thjeshtat kanë ndërtim jashtëzakonisht të ndërlikuar. Qeliza e një gjallese është shumë më e ndërlikuar se të gjitha produktet teknologjike që ka arritur të prodhojë njeriu. Sot, madje edhe në laboratorët më të përparuara të botës, duke bashkuar materie kimike organike, nuk do të mund të arrijmë kurrë të përfitojmë një qelizë të vetme.

Kushtet që nevojiten për formimin e një qelize janë aq të shumta sa kurrë nuk mund të shpjegohen me rastësi. Probabiliteti që proteinat, njësia bazë e qelizës, të sintetizohen rastësisht është 1 në

$10^{950}$  (për një proteinë mesatare me 500 aminoacide). Në matematikë probabilitetet më të vogla se  $10^{50}$  konsiderohen të pamundura.

Molekula e ADN-së përmban informacionet gjenetike si një bankë informacionesh me kapacitet të pabesueshëm. Nëse do ta hidhnim në letër informacionin që përfshin ADN-ja e njeriut, do të krijohej një bibliotekë me 900 volume enciklopedike me nga 500 faqe secili.

Në këtë pikë shfaqet një dilemë shumë interesante: ADN-ja mund ta kopjoj/përsëris vetveten vetëm me ndihmën e disa proteinave të specializuara (enzimave). Mirëpo, sinteza e këtyre enzimave mund të realizohet vetëm me anë të informacionit të koduar në ADN. Pasi që ato të dyja janë të varura nga njëra tjetra, ato duhet të ekzistojnë në të njëjtën kohë për kopjim/përsëritje. Kjo e sjellë skenarin se jeta ka zënë fill vetvetiu në një rrugë pa krye. Prof. Lesli Orgel, një evolucionist me reputacion nga Universiteti i San Diegos në Kaliforni, e pranon këtë fakt në botimin e revistës *Scientific American* të Shtatorit të vitit 1994:

*Është krejtësisht e pamundshme që proteinat dhe acidet nukleike, duke qenë të dyja komplekse për nga ndërtimi, të jenë krijuar vetvetiu në të njëjtin vend dhe në të njëjtën kohë. Po ashtu duket e pamundshme ta kemi njëzënë pa tjetrën. Dhe kështu, në shikim të parë, njeriut do t'i duhej të vjen në përfundimin se, në të vërtetë, jeta kurrë nuk ka mundur të zë fill me anë të mjeteve kimike.<sup>6</sup>*

Padyshim, nëse është e pamundur që jeta të ketë zënë fill nga shkaqet natyrore, atëherë duhet të pranohet se jeta u “krijua” në



mënyrë të mbinatyrshe. Ky fakt zhvlerëson në mënyrë të qartë teorinë e evolucionit, qëllimi kryesor i së cilës është të mohoj krijimin.

## **Mekanizmat imagjinarë të evolucionit**

Çështja e dytë e rëndësishme që e bën teorinë e Darvinit të pavlefshme është se të dy konceptet e paraqitura nga kjo teori si “mekanizma të evolucionit”, u kuptua se në të vërtetë nuk zotërojnë asnjë forcë evoluese.

Darvini e mbështeti hipotezën e tij në tërësi në mekanizmin e “seleksionimit natyror.” Rëndësia që i jepte këtij mekanizmi mund të kuptohet fare lehtë edhe nga titulli i librit të tij: Origjina e Llojeve nëpërmjet seleksionimit natyror”...

Seleksionimi natyror pohon se ato gjallesa që janë më të fuqishme dhe që i përshtaten më mirë kushteve natyrore të vendbanimeve të tyre do të mbijetojnë në luftën për jetë. P.sh., në një kope sorkadhesh që kërcënohet prej kafshëve të ndryshme grabitqare, do të mbijetojnë vetëm ato sorkadhe që vrapojnë më shpejt. Kështu që kopeja e sorkadheve do të përbëhet nga individët më të fortë dhe më të shpejtë. Mirëpo, sigurisht që ky mekanizëm nuk mund të shkaktojë evoluimin e sorkadheve e t’i kthejë në një lloj tjetër gjallese, për shembull, në kuaj.

Për këtë arsye, mekanizmi i seleksionimit natyror nuk zotëron asnjë forcë evoluese. Edhe Darvini ishte i ndërgjegjshëm për këtë realitet, ndaj në librin e tij Origjina e Llojeve u detyrua të pohonte:

*Seleksionimi natyror s’mund të bëjë asgjë përderisa nuk shfaqen dallime dhe ndryshime të dobishme individuale.<sup>7</sup>*

## **Ndikimi i Lamarkut**

Si mund të formoheshin këto ndryshime të dobishme? Darvini, kësaj pyetjeje u mundua t'i përgjigjej nga këndvështrimi i të kuptuarit primitiv të shkencës së asaj kohe. Sipas biologut francez Shevalie Lamark (1774-1829), i cili ka jetuar para Darvinit, gjallesat ia përcollën brezit pasardhës të gjitha ndryshimet fizike, të cilat kishin fituar gjatë jetës së tyre. Ai pohonte se këto cilësi, të cilat u akumuluan nga një brez në tjetrin, bënë që të formohen specie të reja. Për shembull, ai pohonte se gjirafat evoluuan nga antilopat gjatë përpjekjeve të tyre për të arritur gjethet e pemëve të larta, qafat e tyre u zgjatën nga njëri brez në tjetrin Edhe Darvini ka dhënë shembuj të ngjashëm. Në librin e tij Origjina e Llojeve, për shembull, ai thotë se disa arinj për të gjetur ushqim në thellësi të detit me kohë u shndërruan në balena.<sup>8</sup>

Por zbulimet e Gregor Mendelit (1822-1884) të ligjeve të trashëgimisë, të cilat u saktësuan nga shkenca e gjenetikës, e cila lulëzoi në shekullin e njëzet, hedhën poshtë plotësisht legjendën e përcjelljes së karakteristikave të fituara në brezat pasardhës. Kështu, u vërtetua përfundimisht se seleksionimi natyror ishte një mekanizëm joefektiv.

## **Neo-darvinizmi dhe mutacionet**

Për të gjetur një zgjidhje, darvinistët nxorën në dritë “Teorinë Sintetike Moderne”, apo siç njihet ndryshe Neo-Darvinizmin, në fund të viteve 1930. Neo-Darvinizmi shtoi mutacionet, të cilat janë shtrembërime të formuara në gjenet e gjallesave për shkak të

faktorëve të tillë të jashtëm si rrezatimi apo gabimet në përsëritje, si “shkaqe të ndryshimeve të dobishme” përveç mutacionit natyror.

Modeli, i cili edhe sot e ruan vlerën në emër të evolucionit, është Neo-Darvinizmi. Sipas kësaj teorie miliona gjallesa në botë u formuan si rezultat i një procesi me anën e të cilit organe të shumta komplekse të këtyre organizmave (p.sh., veshët, mushkëritë dhe krahët) iu nënshtruan “mutacioneve,” domethënë çrregullimeve gjenetike. Por ekziston një fakt i prerë shkencor që plotësisht e hedh poshtë këtë teori: Mutacionet nuk i zhvillojnë gjallesat, përkundrazi, ato janë gjithmonë të dëmshme.

Arsyeja për këtë është shumë e thjeshtë: ADN-ja zotëron një ndërtim shumë të ndërlikuar dhe çdo ndikim spontan mbi këtë molekulë, mund vetëm t’i shkaktojë dëm asaj. Gjeneticisti amerikan B. G. Ranganathan e shpjegon këtë fakt si në vazhdim:

*Së pari, mutacionet e vërteta janë shumë të rralla në natyrë. Së dyti, shumica e mutacioneve janë të dëmshme pasi që janë të rastësishme, më parë se ndryshime të rregullta në strukturën e gjeneve; çfarëdo ndryshimi i rastësishëm në një sistem tejet të rregullt do të ndikojë për të keq, jo për të mirë. Për shembull, nëse një tërmet do të dridhte një ndërtim tejet të rregullt siç është një ndërtesë, do të ndodhte një ndryshim i rastësishëm në kornizën e ndërtesës, i cili sipas të gjitha gjasave, nuk do të ishte një përmirësim.<sup>9</sup>*

Nuk çudit fakti se deri më sot nuk është vëzhguar asnjë rast i donjë mutacioni të dobishëm, domethënë, i cili është parë të zhvilloj kodin gjenetik. Është vërtetuar se të gjitha mutacionet janë

të dëmshme. Është kuptuar se mutacioni, i cili është paraqitur si një “mekanizëm i evolucionit,” është në të vërtetë një dukuri gjenetike që dëmton gjallesat dhe i lë të gjymtuara. (Efekti më i zakonshëm i mutacionit në qeniet njerëzore është kanceri.) Natyrisht, një mekanizëm shkatërrues nuk mund të jetë “mekanizëm evolutiv.” Seleksionimi natyror, në anën tjetër, “s’ mund të bëj asgjë i vetëm,” siç e pranoi edhe Darvini. Ky fakt na tregon se nuk ekziston ndonjë “mekanizëm evolutiv” në natyrë. Pasi që nuk ekziston asnjë mekanizëm evolutiv, asnjë proces i tillë i imagjinuar i quajtur “evolucion” nuk ka mundur të ndodhë.

## **Të dhënat fosile: asnjë gjurmë e formave kalimtare**

Të dhënat fosile janë treguesi më i qartë se skenari që sugjerohet nga teoria evolucionit nuk ka ndodhur kurrë.

Sipas kësaj teorie, të gjitha gjallesat kanë evoluar nga një paraardhës. Një specie, e cila ekzistonte më parë, me kalimin e kohës, u shndërrua në diçka tjetër dhe të gjitha speciet u krijuan në këtë mënyrë. Me fjalë të tjera, ky transformim u zhvillua gradualisht gjatë një periudhe të gjatë prej qindra miliona vjetësh.

Po të kishte qenë kështu, lloje të shumta kalimtare duhej të kishin ekzistuar dhe jetuar brenda kësaj periudhe të gjatë transformimi.

Për shembull, disa krijesa gjysmë peshk–gjysmë zvarranik duhej të kishin jetuar në të kaluarën të cilat kishin fituar disa tipare zvarranikësh, përveç tipareve të peshkut të cilat ato tashmë i

kishin. Apo duhej të kishin ekzistuar disa zvarranik-zogj, të cilët fituan disa tipare të zogjve përveç tipareve të zvarranikëve që ato tashmë i kishin. Meqë këto gjallesa do të duhej të kishin ekzistuar në një periudhë kalimtare, gjallesat duhet të kenë qenë të gjymtuara dhe me një sërë të metash. Evolucionistët, këto qenie imagjinare që besojnë të kenë jetuar në të kaluarën, i quajnë “forma kalimtare”.

Nëse me të vërtetë do të kishin ekzistuar gjallesa të tilla në të kaluarën, atëherë do të duhej të kishte me miliona dhe madje miliarda sosh për nga numri dhe llojllojshmëria. Ajo që është më me rëndësi, mbetjet e këtyre qenieve të çuditshme do të duhej të haseshin në të dhënat fosile. Darvini, në librin Origjina e Llojeve, këtë fakt e shpjegon kështu:

*Nëse teoria ime është e vërtetë, atëherë forma kalimtare të panumërta që lidhin speciet e të njëjtit grup, duhet të kenë ekzistuar sigurisht... Si rrjedhim, provat për ekzistencën e tyre të mëparshme do të mund të gjendeshin vetëm në mbetjet fosile.”<sup>10</sup>*

## **Shpresat e venitura të Darvinit**

Mirëpo, edhe pse janë bërë shumë kërkime intensive për të gjetur fosilet që nga mesi i shekullit të nëntëmbëdhjetë në mbarë botën, ende nuk është gjetur asnjë formë kalimtare. Të gjitha fosilet, në kundërshtim me atë që shpresonin evolucionistët, tregojnë se jeta në Tokë u shfaq rastësisht, krejt papritur dhe plotësisht e formuar.

Një paleontolog i njohur britanik, Derek V. Ager, edhe pse një evolucionist, e pranon këtë realitet:

*Problemi ynë është ky: Tek analizojmë me hollësi të dhënat fosile në nivelin e klasave apo llojeve, hasim gjithmonë e më tepër jo evolucion gradual, por shpërthim të papritur të një lloji në llogari të një tjetri.<sup>11</sup>*

Me fjalë të tjera, te fosilet e gjetura, të gjitha llojet e gjallesave shfaqen papritmas dhe në formën e tyre të përfunduar, pa asnjë formë të ndërmjetme në mes. Kjo është pikërisht e kundërta e supozimeve të Darvinit. Për më tepër, kjo është një provë shumë e fortë që gjallesat janë krijuar. I vetmi shpjegim që një specie e gjallë të shfaqet papritmas e plotë dhe pa paraardhës nga i cili të ketë evoluar është se ajo u krijua. Kjo e vërtetë është pranuar po ashtu nga biologu i mirënjohur evolucionist Douglas Futuyuma:

*Krijimi dhe evolucionin janë dy shpjegimet e vetme që mund të bëhen rreth origjinës së qenieve të gjalla. Krijimi dhe evolucionin, në mes tyre, shter shpjegimet e mundshme për zanafillën e gjallesave. Organizmat ose janë shfaqur në tokë të zhvilluara plotësisht, ose jo. Në rast se nuk janë zhvilluar gradualisht, ato duhet të jenë zhvilluar nga specie që kanë ekzistuar më parë me anë të ndonjë procesi modifikimi. Në rast se janë shfaqur plotësisht të zhvilluara, ato me të vërtetë duhet të jenë krijuar nga ndonjë intelekt i plotfuqishëm.<sup>12</sup>*

Fosilet tregojnë se qeniet e gjalla u shfaqën në Tokë të formuara plotësisht dhe në gjendje të përkryer. Me fjalë të tjera “origjina e llojeve,” në kundërshtim me supozimin e Darvinit, nuk është evolucionin, por krijimi.

## **Përralla e evolucionit të njeriut**

Çështja që trajtohet më shpesh nga mbrojtësit e teorisë së evolucionit është prejardhja e njeriut. Mendimi darvinist mbi këtë çështje thotë se qeniet njerëzore moderne që jetojnë sot kanë evoluar nga disa krijesa të ngjashme me majmunët. Gjatë kësaj periudhe të supozuar, e cila mendohet të ketë filluar rreth 4-5 milionë vjet më parë, pretendohet se kanë jetuar “forma kalimtare” midis njeriut modern dhe të parëve të tij. Ka katër “kategori” bazë në gjithë këtë skenar të imagjinuar:

1. Australopiteku
2. Homo habilis
3. Homo erectus
4. Homo sapiens

Evolucionistët i japin emrin “Australopitek” (që do të thotë “majmuni i jugut”), të ashtuquajturit paraardhës të parë të njeriut të ngjashëm me majmunët. Këto qenie të gjalla nuk janë në fakt asgjë tjetër, përveçse një specie e zhdukur majmuni. Kërkimet e shumta të Lordit Solli Cukerman dhe Profesorit Çarlls Oksnard, dy anatomistë me famë botërore nga Anglia dhe SHBA-ja, rreth mbetjeve të australopitekëve tregojnë se këto qenie i përkisnin një lloji të majmunit të zhdukur dhe se nuk kishin asnjë ngjashmëri me qeniet njerëzore.<sup>13</sup>

Evolucionistët e quajnë fazën tjetër të evolucionit njerëzor “homo,” domethënë “njeri”. Sipas këtij pretendimi, qeniet e gjalla të serisë “homo” ishin më të zhvilluara se australopitekët. Evolucionistët i vendosën fosilet e këtyre krijesave të ndryshme pranë njëra-tjetrës me një renditje të caktuar dhe përpiluan një plan imagjinar evolucionit. Ky plan është imagjinar, sepse faktikisht asnjë

lidhje evolucionare mes këtyre klasave të ndryshme nuk është provuar. Ernst Majër, njëri prej mbrojtësve më të rëndësishëm të teorisë së evolucionit në shekullin e njëzet në librin e tij Një argument i gjatë pohon se: “në veçanti (enigmat) historike si zanafilla e jetës apo e Homo sapiensit, janë tejet të vështira dhe mund madje t’i bëjnë ballë një shpjegimi përfundimtar të kënaqshëm.”<sup>14</sup>

Kur konturojnë zinxhirin Australopitek > Homo Habilis > Homo Erektus > Homo Sapiens, evolucionistët nënkuptojnë se këto specie kanë qenë paraardhëse të njëra-tjetrës. Mirëpo, zbulimet më të fundit të paleo-antropologëve tregojnë se Austrolopiteku, Homo Habilis dhe Homo Erektus kanë jetuar në të njëjtën periudhë në pjesë të ndryshme të botës.<sup>15</sup>

Për më tepër, një segment i caktuar njerëzish i klasifikuar si Homo Erektus ka jetuar deri në kohërat moderne. Homo sapiensi, Neandertalët dhe Homo Sapiens Sapiens (njeriu modern) kanë bashkëjetuar në të njëjtin rajon.<sup>16</sup>

Kjo, sigurisht, provon përfundimisht se këto specie nuk ishin paraardhëse të njëra-tjetrës. Stefën Xhej Gould, njëri prej paleontologëve të universitetit të Harvardit, megjithëse është evolucionist, e shpjegon qorrsokakun në të cilin gjendet teoria darviniste në këtë mënyrë:

*Çfarë i ndodhi shkallës sonë, nëse bashkekzistojnë tri linja hominide (A. Afrikanus, Robust Australopitekët robust (shtatmëdhenj) dhe H. Habilis) që nuk rrjedhin nga njëra-tjetra? Për më tepër, asnjë nga të tre nuk shfaq ndonjë tendencë evolutive gjatë qëndrimit të tyre në tokë.*<sup>17</sup>



Me pak fjalë, i gjithë skenari i evolucionit njerëzor që po mbahet gjallë me ndihmën e vizatimeve të ndryshme të krijesave imagjinare “gjysmë-majmun-gjysmë-njeri”, që shfaqen në media apo libra shkollorë, domethënë, sinqerisht, me anë të metodave propagandistike, s’janë gjë tjetër veçse një mit pa asnjë bazë shkencore.

Lordi Solli Cukerman, një nga shkencëtarët më të njohur dhe më të spikatur të Mbretërisë së Bashkuar, e ka studiuar këtë çështje për vite me radhë dhe ka kryer një punë kërkimore 15-vjeçare mbi fosilet e Australopitëkut. Edhe pse evolucionist, ai arriti në përfundimin se, në të vërtetë, nuk ekziston asnjë pemë gjenealogjike midis majmunit dhe njeriut.

Cukerman gjithashtu bëri një “spektër interesant të shkencave”, duke i radhitur ato nga ato që ai i konsideronte si më shkencoret tek ato që i konsideronte si më joshkencoret. Sipas spektrit të Cukermanit, më “shkencoret,” duke marrë parasysh mbështetjen e tyre në argumente, janë shkenca e fizikës dhe kimisë. Më pas vijnë shkencat biologjike dhe pastaj shkencat shoqërore. Në fund fare, në pjesën që konsiderohet të jetë si pjesa më “joshkencore”, radhitet “perceptimi jashtë-shqisor” – konceptet si telepatia dhe shqisa e gjashtë – dhe në fund të fundit u vendos “evolucionit i njeriut”. Cukerman shpjegon kështu arsyetimin e tij:

*Më pas zhvendosim regjistrin e të vërtetës objektive në drejtim të atyre fushave të shkencës të konsideruara si shkenca biologjike, si p.sh. perceptimi jashtë-shqisor apo interpretimi i historisë së fosileve të njeriut, ku për (evolucionistin) besnik gjithçka është e mundur – dhe ku besimtari i zjarritë (i*

*evolucionit ndonjëherë është në gjendje të besojë shumë gjëra kontradiktore në të njëjtën kohë.*<sup>18</sup>

Siç shihet, evolucioni njerëzor nuk është gjë tjetër veçse një përmbledhje e “disa interpretimeve të paragjykuara të fosileve të zhvarrosura prej njerëzve të caktuar, të cilët ndjekin verbërisht teorinë e tyre.

### **Formula e Darvinit!**

Përveç të gjitha provave teknike me të cilat jemi marrë gjer më tani, le ta shtjellojmë njëherë, se çfarë paragjykimi kanë evolucionistët me një shembull të thjeshtë që të kuptohet madje edhe prej fëmijëve:

Teoria e evolucionit pohon se jeta u krijua rastësisht. Sipas këtij pohimi, atomet e pajetë dhe të pavetëdije u bashkuan për të formuar qelizën dhe pastaj ata disi formuan gjallesat tjera, duke përfshirë edhe njeriun. Le të mendojmë për këtë. Kur i bashkojmë elementet që janë bazë e ndërtimit jetës si karboni, fosfori, nitrogjeni dhe potasiumi, vetëm një grumbull formohet. Pa marrë parasysh se çfarë trajtimi i nënshtrohet, ky grumbull atomesh nuk mund të formojë madje as edhe një gjallesë të vetme. Nëse dëshironi, le ta formulojmë një “eksperiment” në lidhje me këtë çështje dhe ta shtjellojmë në emër të evolucionistëve atë që ata vërtet e pohojnë pa e shprehur zëshëm me emrin “formula e Darvinit”:

Le të vendosin materialistët plot materiale të pranishme në përbërjen e gjallesave si fosfori, nitrogjeni, karboni, oksigjeni, hekuri dhe magneziumi në fuçi të mëdha. Veç kësaj, le të shtojnë

në këto fuçi çfarëdo lloj materiali që nuk ekziston në kushte normale, por që ata mendojnë se është i domosdoshëm. Le të shtojnë në këtë përzierje aq sa të dëshirojnë amino acide – të cilat nuk kanë mundësi të formohen në kushte natyrore – dhe proteina – që një e vetme e ka probabilitetin e formimit 10 në 950 – sa të duan. Le t'ia ekspozojnë këto përzierje deri në masën që dëshirojnë nxehtësisë dhe lagështisë. Le t'i përziejnë këto me çfarëdo pajisje të përparuar teknologjike që të duan. Le t'i vënë shkencëtarët më të shquar pranë këtyre fuçive. Le të presin këta ekspert me radhë pranë këtyre fuçive për miliarda dhe trilionë vite. Le të lejohen të përdorin të gjitha llojet e kushteve që ata besojnë të jenë të domosdoshme për formimin e një njeriu. Pa marrë parasysh se çfarë bëjnë, ata nuk mund ta krijojnë një njeri prej këtyre fuçive, të themi një profesor që ekzaminon strukturën e qelizës së tij nën një mikroskop elektronik. Ata nuk mund të krijojnë gjirafa, luanë, bletë, kanarina, kuaj, delfinë, trëndafila, orkide, zambakë, karafila, banane, portokaj, molla, hurma, domate, pjepër, shalqi, fiq, ullinj, rrush, pjeshka, pallojë, fazanë, flutura shumëngjyrëshe apo me miliona gjallesa si këto. Me të vërtetë, ata nuk do të mund të përfitonin as edhe një qelizë të vetme prej cilëdo prej tyre.

Thënë shkurt, atomet e pavetëdijshme nuk mund të formojnë qelizën duke u bashkuar. Ato nuk mund të marrin një vendim të ri dhe ta ndajnë këtë qelizë më dysh dhe pastaj të marrin vendime tjera dhe të krijojnë profesorët të cilët së pari shpikin mikroskopin elektronik dhe pastaj ekzaminojnë strukturën e qelizës së vet nën atë mikroskop. Materia është një grumbull i pavetëdijshëm, i pajetë dhe ajo vjen në jetë me krijimin e lartë të Allahut.

Teoria e evolucionit, e cila pohon të kundërtën e kësaj, është një gjykim plotësisht i gabuar i kundërt me arsyen. Të menduarit madje edhe vetëm për pak kohë për pohimet e evolucionistëve zbulon këtë të vërtetë, sikurse në shembullin më lartë.

## **Teknologjia e syrit dhe veshit**

Një çështje tjetër që mbetet pa përgjigje nga teoria e evolucionit është cilësia e shkëlqyer e perceptimit të syrit dhe veshit.

Para se të kalojmë te syri, le t'i përgjigjemi shkurtimisht pyetjes "Si shohim ne?" Rrezet e dritës që vijnë nga një objekt, bien në retinën e syrit duke dhënë një imazh të përmbysur të objektit. Këtu, këto rreze drite transformohen në sinjale elektrike nga qelizat dhe pastaj përcillen në një zonë të vogël në pjesën e prapme të trurit, ku ndodhet "qendra e shikimit". Këto sinjale elektrike perceptohen në këtë qendër të trurit si imazh pas një sërë procesesh. Le të mendojmë pak, duke u bazuar në këto njohuri teknike.

Truri është i izoluar tërësisht nga drita. Kjo do të thotë se pjesa e brendshme e trurit është në errësirë të plotë dhe drita nuk arrin atje. Qendra e shikimit është një vend në errësirë të plotë ku nuk hyn kurrë dritë. Ka mundësi që të jetë vendi më i errët që ekziston. Megjithatë, ne shikojmë një botë të ndritshme plot dritë në këtë errësirë të plotë.

Imazhi i formuar në sy është kaq i mprehtë dhe i qartë, sa që as teknologjia e shekullit njëzet nuk ka arritur ta realizojë. Për shembull, shikoni librin që jeni duke e lexuar, duart me të cilat e mbani atë dhe pastaj ngrini kokën dhe shikoni përreth. A keni parë ndonjëherë një imazh të tillë të mprehtë e të qartë si ky në ndonjë

vend tjetër? Edhe ekrani më i zhvilluar i televizorit i prodhuar nga prodhuesi më i fuqishëm i televizorëve në botë nuk mund të sigurojë një imazh aq të mprehtë për ju. Ky është një imazh tre-dimensional, me ngjyra dhe jashtëzakonisht i pastër. Për vite të tëra, mijëra inxhinierë janë përpjekur të prodhojnë një televizor tre-dimensional, i cili mund të arrijë cilësinë e shikimit të syrit. Ata kanë arritur të shpikin një sistem TV tre-dimensional, por ai nuk mund të shihet pa vendosur një palë syze speciale 3-D. Për më tepër, bëhet fjalë vetëm për një tre-dimensional artificial. Sfondi është më i mjegulluar, ndërsa plani i parë duket sikur është dekor prej letre. Asnjëherë s'ka qenë e mundur të arrihet një imazh me cilësinë e syrit. Edhe në kamera apo në televizor, ka një humbje të cilësisë së imazhit.

Evolucionistët pretendojnë se mekanizmi që prodhon këtë imazh të mprehtë e të qartë është formuar krejt rastësisht. Nëse dikush do t'ju thoshte se televizori në dhomën tuaj është formuar si rezultat i bashkimit të rastësishëm të miliona atomeve, çfarë do të mendonit ju? Si mund ta bëjnë atomet atë që mijëra njerëz s'e bëjnë dot?

Nëse një pajisje që prodhon një imazh më primitiv se syri nuk mund të jetë formuar rastësisht, atëherë është shumë e qartë që edhe syri apo imazhi që shikohet prej tij nuk mund të jenë krijuar rastësisht. E njëjta gjë vlen edhe për veshin. Veshi i jashtëm i kap tingujt dhe i drejton te veshi i mesëm, i cili ia përcjell veshit të brendshëm duke i përforcuar ato. Veshi i brendshëm ia dërgon valët zanore trurit, duke i kthyer në sinjale elektrike. Ashtu si me shikimin, procesi i dëgjimit përfundon në qendrën e dëgjimit në tru.

Ajo që thamë për syrin është e vërtetë edhe për veshin. D.m.th. truri është i izoluar nga tingujt, ashtu si është i izoluar edhe nga drita: asnjë tingull nuk mund të depërtojë brenda. Prandaj, s'ka rëndësi sa zhurmë ka jashtë, brenda trurit mbizotëron një qetësi absolute. Megjithatë edhe tingujt më të mprehtë perceptohen nga truri.

Nëpërmjet trurit tonë, i cili është i izoluar nga tingujt, ne dëgjojmë simfoninë e ekzekutuar nga një orkestër apo zhurmat në një vend të mbushur plot me njerëz. Megjithatë, nëse bëhet një matje ekzakte e nivelit të tingujve në trurin tonë në këto momente, do të kuptonim se një qetësi absolute mbizotëron aty.

Ashtu si në rastin e imazhit, dekada të tëra përpjekjesh kanë kaluar për të krijuar dhe riprodhuar tinguj sa më të afërt me origjinalin. Rezultatet e këtyre përpjekjeve janë regjistruarit e zërit, sistemet HI-FI dhe sistemet e ndryshme për kapjen e tingujve. Pavarësisht nga teknologjia e përparuar dhe përpjekjet e mijëra inxhinierëve e ekspertëve, nuk është përfituar asnjë tingull që të ketë të njëjtën mprehtësi dhe qartësi si tingulli që kapet nga veshi. Mendoni për sistemet HI-FI të cilësisë më të lartë të prodhuar nga kompania më e madhe e industrisë së muzikës. Edhe në këto pajisje, kur regjistrohet zëri, humbet një pjesë e cilësisë. Kur ndizni një HI-FI gjithmonë dëgjoni një zhurmë të lehtë para se të fillojë muzika. Veshi i njeriut asnjëherë nuk e kap një tingull të shoqëruar me zhurmë; ai e kap tingullin pikërisht ashtu siç është, i mprehtë e i qartë. Kështu ka qenë gjithmonë që nga krijimi i njeriut.

## **Kujt i takon ndërgjegjja që sheh dhe dëgjon në brendi të trurit?**

Kush shikon një botë joshëse në trurin tonë, dëgjon simfonitë dhe cicërimën e zogjve dhe ndien aromën e trëndafililit?

Nxitjet që vijnë prej syve, veshëve dhe hundës së një personi shkojnë në tru si impulse nervore elektro-kimike. Në librat e biologjisë, fiziologjisë dhe biokimisë, mund të gjeni shumë hollësi për mënyrën se si ky imazh formohet në tru. Mirëpo, kurrë nuk do të mund të ndesheni me faktin më të rëndësishëm: Kush i pranon këto impulse nervore elektro-kimike si imazhe, tinguj, aroma dhe ngjarje shqisore në tru? Ekziston një ndërgjegje në tru që i pranon gjithë këto pa ndier ndonjë nevojë për një sy, vesh apo hundë. Kujt i takon kjo ndërgjegje? Natyrisht se nuk u takon nervave, shtresës yndyrore dhe neuroneve që e përbëjnë trurin. Kjo është arsyeja pse darvinistët-materialist, të cilët besojnë se gjithçka përbëhet prej materies, nuk mund të japin përgjigje në këto pyetje.

Sepse kjo ndërgjegje është shpirti i krijuar prej Allahut, i cili nuk ka nevojë as për syrin për të shikuar imazhet dhe as për veshin për t'i dëgjuar tingujt. Për më tepër, nuk ka nevojë për trurin për të menduar.

Çdo njeri që e lexon këtë fakt të qartë shkencor do të duhej të mendonte thellë për Allahun e Gjithëfuqishëm dhe të ketë frikë dhe të kërkoj strehim tek Ai, sepse Ai ngjesh tërë gjithësinë në një vend plotësisht të errët prej disa centimetrave kub në një formë tre-dimensionale, me ngjyra, me hije dhe të ndritshme.

## **Një besim materialist**

Informacioni që kemi paraqitur deri tani tregon se teoria e evolucionit është një pretendim që bie hapur në kundërshtim me faktet shkencore. Pretendimi i teorisë në lidhje me prejardhjen e jetës është në kundërshtim me shkencën, mekanizmat e evolucionit të propozuara nga kjo teori nuk kanë asnjë forcë evolutive, dhe fosilet tregojnë se format kalimtare nuk kanë ekzistuar kurrë. Prandaj, teoria e evolucionit duhet të hidhet poshtë si një ide joshkencore. Në këtë mënyrë shumë ide, si modeli i gjithësisë me qendër Tokën, janë nxjerrë jashtë agjendës së shkencës gjatë historisë.

Por teoria e evolucionit vazhdon të mbahet me vendosmëri në listën e teorive shkencore. Disa njerëz madje përpiqen t'i paraqesin kritikën në adresë të saj si “sulm ndaj shkencës”. Po pse ndodh kjo gjë?

Arsyeja për këtë situatë të krijuar është se për disa njerëz të cilët u përkasin disa qarqeve të caktuara, teoria e evolucionit është shndërruar në një besim dogmatik të domosdoshëm. Këto qarqe kapen fort pas filozofisë materialiste dhe ndikohen nga Darwinizmi, i cili për ta është shpjegimi i vetëm materialist për natyrën.

Nganjëherë ata e pranojnë hapur këtë. Riçard Levontin, gjenetist i famshëm nga universiteti i Harvardit dhe në të njëjtën kohë një evolucionist i njohur pranon se është “së pari materialist, pastaj shkencëtar”:



*Nuk është puna se metodat dhe institucionet e shkencës në njëfarë mënyre na detyrojnë të pranojmë një shpjegim material për botën, por përkundrazi, ne jemi të detyruar nga përkrahja jonë arbitrare e kauzës materialiste të krijojmë një aparat hetimi dhe një sërë konceptesh që japin shpjegime materiale, edhe nëse janë kundër intuitës, pa marrë parasysh se sa të mjegullta janë për të panisurën. Për më tepër, materializmi është absolut, kështu që ne nuk mund të lejojmë të dalë në skenë një Qenie Hyjnore.<sup>19</sup>*

Këto fjalë janë deklarata të qarta se Darwinizmi është një dogmë e mbajtur gjallë për hir të lidhjes me filozofinë materialiste. Sipas kësaj dogme asgjë nuk ekziston përveç materies. Prandaj, ajo predikon se materia e pajetë dhe e pavetëdijshme krijoi jetën. Ajo këmbëngul se miliona specie të gjalla, (si zogjtë, peshqit, kafshët, insektet, pemët, lulet, balenat dhe qeniet njerëzore) u shfaqën si pasojë e bashkëveprimit të materies si shiut, rrufeve dhe kështu me radhë prej materies së pajetë. Ky besim është në kundërshtim të plotë si me arsyen ashtu edhe shkencën. Por darvinistët vazhdojnë të mbrojnë këtë besim me qëllim që “të mos lejojnë daljen në skenë të një Qenie Hyjnore.”

Kushdo që nuk e shikon prejardhjen e gjallesave me paragjykim materialist do ta kuptojë këtë të vërtetë të qartë: të gjitha gjallesat janë rezultat i krijimit të një Krijuesi, i Cili zotëron fuqi, dije dhe inteligjencë superiore. Ky Krijues është Allahu, i Cili krijoi tërë gjithësinë nga asgjëja, i Cili e konstruktoi atë në mënyrën më të përkryer dhe u dha formë të gjitha gjallesave.

## **Teoria e evolucionit:**

### **Magjia më e fuqishme në botë**

Çdo njeri i lirë prej paragjykimit dhe ndikimit të çfarëdo ideologjie të caktuar, që përdor arsyen dhe logjikën e tij apo të saj, do të kuptojë qartë se besimi në teorinë e evolucionit, i cili na përkujton besëtytnitë e shoqërive pa dijeni të shkencës apo qytetërimit, është plotësisht i pamundshëm.

Siç u shpjegua më lartë, ata që besojnë në teorinë e evolucionit mendojnë se disa atome dhe molekula të hedhura në një fuçi të madhe do të mund të krijojnë profesorë dhe studentë universiteti që janë në gjendje të mendojnë dhe gjykojnë; shkencëtarë si Ajnshtajni dhe Galileo; artistë si Hemfri Bogart, Frenk Sinatra dhe Luçano Pavaroti; si edhe antilopa, drurë limoni dhe karafila. Për më tepër, pasi që shkencëtarët dhe profesorët të cilët besojnë në këto gjepura janë njerëz të shkolluar, është krejtësisht e arsyeshme të flitet për këtë teori si për “magjinë më të fuqishme në histori.” Asnjëherë më parë asnjë besim apo ide tjetër nuk ua ka larguar aftësinë e të gjykuarit të njerëzve, nuk ka pranuar t’i lejojë ata të mendojnë me mençuri dhe me arsye dhe ua ka fshehur të vërtetën sikur ata t’i kishin sytë e lidhur. Kjo është një verbëri madje edhe më e keqe dhe më e pabesueshme se adhurimi i Zotit të Diellit Ra nga egjiptianët, adhurimi i totemeve në disa pjesë të Afrikës, adhurimi i Diellit nga populli i Sabës, adhurimi i idhujve që kishin mbaruar me duart e tyre nga ana e fisit të Profetit Ibrahim (paqja qoftë mbi të) apo adhurimi i Viçit të Artë nga ana e popullit të Profetit Musa (paqja qoftë mbi të).

Në të vërtetë, Allahu ka theksuar këtë mungesë arsyeje në

Kuran. Në shumë vargje, Ai zbulon se mendjet e disa njerëzve do të jenë të mbyllura dhe se ata do të jenë të pafuqishme të shohin të vërtetën. Disa nga këto vargje jepen në vazhdim:

**Sa për ata që mohojnë, njësoj është, i paralajmërove apo nuk i paralajmërove - ata nuk besojnë. Allahu i ka vulosur zemrat e tyre, ndërsa në veshët dhe sytë e tyre kanë mbulesë; ata i pret një dënim i madh. (Sure Bekare: 6-7)**

**... Ata kanë zemra me të cilat nuk kuptojnë. Ata kanë sy me të cilët nuk shohin. Ata kanë veshë me të cilët nuk dëgjojnë. Ata janë si kafshët, bile edhe më të humbur! Ata janë të pavetëdijshëm. (Sure A'raf: 179)**

**Edhe sikur Ne t'u hapnim atyre një derë në qiell dhe të ngjiteshin vazhdimisht lart në të (e të shihnin engjëjt e fshehtësitë), ata vetëm do të thoshin: "Neve na janë ndalë sytë (të parët). Jo, ne jemi njerëz të magjepsur. (Sure Hixhr: 14-15)**

Fjalët nuk mund ta shprehin se sa është e habitshme se si kjo magji ka arritur të mbajë një komunitet aq të gjerë në skllavëri, t'i largojë njerëzit nga e vërteta dhe të mos ndërpritet për 150 vjet. Është e kuptueshme se një apo disa njerëz do të mund të besonin në skenarë dhe pohime të pabesueshme përplot marrëzi dhe mungesë arsyeje. Mirëpo, "magjia" është shpjegimi i vetëm i mundshëm për njerëzit në mbarë botën që besojnë se atomet e pavetëdijshme dhe të pajetë papritur vendosën të bashkohen dhe të formojnë një gjithësi që funksionon me një sistem të organizimit, rregullit, arsyes dhe vetëdijes së përkryer; një planet të quajtur Tokë me të gjitha veçoritë e saj të përshtatura në mënyrë aq të përkryer për jetën; dhe gjallesat përplot sisteme të panumërta komplekse.

Në të vërtetë, Kurani rrëfen ngjarjen e Profetit Musa dhe Faraonit për të treguar se disa njerëz të cilët përkrahin filozofitë ateiste në të vërtetë ndikojnë tek të tjerët me anë të magjisë. Kur iu tha Faraonit për fenë e vërtetë, ai i tha Profetit Musa të ndeshet me magjistarët e tij. Kur Musai e bëri këtë, ai u tha atyre që të tregojnë aftësitë e tyre të parët. Vargjet pasojnë:

**“Hidhni ju!” – u përgjigj ai. Kur magjistarët hodhën shkopinjtë e tyre, i magjepsën sytë e njerëzve, i frikësuan ata dhe shfaqën një magji të madhe. (Sure A’raf: 116)**

Siç kemi vënë re, magjistarët e Faraonit ishin në gjendje të mashtrorjme çdo njeri, përveç Musait dhe atyre të cilët i besuan atij. Mirëpo, dëshmia e tij zhduki magjinë, apo “gëlltiti atë që ata kishin sajuar,” siç përshkruhet në ajet.

**Atëherë Ne i kumtuam Musait: “Hidhe shkopin tënd!” - dhe ai filloi të gëlltiste gjithçka që trilluan ata. Në këtë mënyrë, doli në shesh e vërteta dhe dështoi ajo që kishin bërë ata. (Sure A’raf: 117-118)**

Siç kemi vënë re, kur njerëzit e kuptuan se ata u magjepsën dhe se ajo që panë ishte vetëm një iluzion, magjistarët e Faraonit humbën gjithë besueshmërinë e tyre. Edhe në ditët tona, përveç nëse ata të cilët, nën ndikimin e një magjie të ngjashme, besojnë në këto pretendime qesharake nën maskën e tyre shkencore dhe kalojnë jetët e tyre duke i mbrojtur ato, i braktisin besimet e tyre paragjyquese, ata po ashtu do të poshtërohen kur e vërteta e plotë shfaqet dhe magjia prishet. Në të vërtetë, Malkolm Magerixh, një filozof ateist dhe përkrahës i evolucionit, pranoi se ishte i brengosur pikërisht nga kjo perspektivë:

*Unë personalisht jam i bindur se teoria e evolucionit, posaçërisht shtrirja e zbatimit të saj, do të jetë njëra prej shakave më të mëdha në librat e historisë në të ardhmen. Brezat e ardhshëm do të çuditen se si një hipotezë aq jo bindëse dhe e dyshimtë ka mundur të pranohej me naivitetin e pabesueshëm që ajo posedon.* <sup>20</sup>

Se e ardhmja nuk është larg: Përkundrazi, njerëzit së shpejti do ta shohin se “rasti” nuk është hyjni dhe do të shikojnë prapa në teorinë e evolucionit si në mashtrimin më të keq dhe magjinë më të tmerrshme në botë. Ajo magji tashmë ka filluar të ngrihet me shpejtësi prej shpatullave të njerëzve në mbarë botën. Shumë njerëz që e shohin fytyrën e saj të vërtetë po pyeten me habi se si është e mundur që të jenë kapluar prej saj.

---

---

***Engjujt thanë: “Larg nga të metat je  
Ti o Zot! Ne nuk kemi asnjë dije tjetër  
përveç asaj që na mësove Ti. Vërtet,  
Ti je i Gjithëdijshtëm e i Urtë.”  
(Sure Bekare: 32)***

---

---

# SHËNIMET

1. Sidney Fox, Klaus Dose, *Molecular Evolution and The Origin of Life*, Ë.H. Freeman and Company, San Francisco, 1972, p. 4.
2. Alexander I. Oparin, *Origin of Life*, Dover Publications, Neë York, 1936, 1953 (reprint), p. 196.
3. "Neë Evidence on Evolution of Early Atmosphere and Life", *Bulletin of the American Meteorological Society*, vol 63, November 1982, p. 1328-1330.
4. Stanley Miller, *Molecular Evolution of Life: Current Status of the Prebiotic Synthesis of Small Molecules*, 1986, p. 7.
5. Jeffrey Bada, *Earth*, February 1998, p. 40.
6. Leslie E. Orgel, "The Origin of Life on Earth", *Scientific American*, vol. 271, October 1994, p. 78.
7. Charles Darëin, *The Origin of Species by Means of Natural Selection*, The Modern Library, Neë York, p. 127.
8. Charles Darëin, *The Origin of Species: A Facsimile of the First Edition*, Harvard University Press, 1964, p. 184.
9. B. G. Ranganathan, *Origins?*, Pennsylvania: The Banner Of Truth Trust, 1988, p. 7.
10. Charles Darëin, *The Origin of Species: A Facsimile of the First Edition*, Harvard University Press, 1964, p. 179.
11. Derek A. Ager, "The Nature of the Fossil Record", *Proceedings of the British Geological Association*, vol 87, 1976, p. 133.
12. Douglas J. Futuyma, *Science on Trial*, Pantheon Books, Neë York, 1983, p. 197.
13. Solly Zuckerman, *Beyond The Ivory Toëer*, Toplinger Publications, Neë York, 1970, pp. 75-14; Charles E. Oxnard, "The Place of Australopithecines in Human Evolution: Grounds for Doubt", *Nature*, vol 258, p. 389.
14. "Could science be brought to an end by scientists' belief that they have final ansëers or by society's reluctance to pay the bills?" *Scientific American*, December 1992, p. 20.
15. Alan Ëalker, *Science*, vol. 207, 7 March 1980, p. 1103; A. J. Kelso, *Physical Antropology*, 1st ed., J. B. Lipincott Co., Neë York, 1970, p. 221; M. D. Leakey, *Olduvai Gorge*, vol. 3, Cambridge University Press, Cambridge, 1971, p. 272.
16. Jeffrey Kluger, "Not So Extinct After All: The Primitive Homo Erectus May Have Survived Long Enough To Coexist Ëith Modern Humans", *Time*, 23 December 1996.
17. S. J. Gould, *Natural History*, vol. 85, 1976, p. 30.
18. Solly Zuckerman, *Beyond The Ivory Toëer*, p. 19.
19. Richard Leëontin, "The Demon-Haunted Ëorld," *The Neë York Revieë of Books*, January 9, 1997, p. 28.
20. Malcolm Muggerridge, *The End of Christendom*, Grand Rapids: Eerdmans, 1980, p. 43.